



*“Dëshira ime ka qenë dhe asht me i shërbye atdheut me çfarëdo mënyre, për të mirën e të cilit nuk paraqes dhe as nuk do të paraqes kondita”* Mirash Ivanaj

## EDITORIAL

### **PËRVJETORËT** nga Andon ANDONI

Sapo u përmyll festa e 85- vjetorit të gjimnazit “Qemal Stafa”, në Tiranë. Një festë e bukur me plot emocion dhe dashuri, siç janë festat e vërteta. Dhe festat, të përbashkuara më figurën e mësuesit dhe nxënësit, janë edhe më të bukura, sepse mbajnë fisnikërinë dhe magjinë e dijes brenda. Tek i vështroje të hynin në derën e shkollës shtatëdhjetë dhe tetëdhjetëvjeçarët e sotëm, nxënës e mësues të dikurshëm, mbusheshe me emocion. Janë të drithëruar prej kujtimeve të rinisë së tyre, rini e papërsëritshme për këdo. Nëse do duhet të shkruajmë për sa e sa emra të lidhur me këtë gjimnaz, do ishte një listë e gjatë që nga fillimet e vitit 1924 e deri në ditët e sotme, porse në këto radhë nuk kemi për qëllim të qëndrojmë në gëzimin e tyre dhe të kësaj feste. Sigurisht mes tyre mungojnë emra që vijnë prej kohës së largët të fillimeve të gjimnazit dhe që shërbyen si mësues ndër vite si Mirash Ivanaj, Aleksandër Xhuvani, Eqerem Çabej, Aleks Buda, Arshi Pipa, Sali Çeka, Dhimitër Shuteriqi, Qazim Turdiu, Gjergji Canco, Selman Riza, Vedat Kokona.... Vetëm kaq pak nga lista e përditësuar deri sot me emrat e nderuar të mësuesve dhe çdo njëri nga nxënësit e sotëm gjimnazistë do ndjehet i nderuar, që është pjesë e këtij gjimnazi.

*vijon në faqen 2*

## RISITË E MATURËS SHTETËRORE 2011

*Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, bashkëbisedon me drejtues, mësues e nxënës të Tiranës*

## ARSIMI & REFORMA

*Mbështetja për autonominë në Arsimin Parauniversitar, sfidë dhe reformë bashkëkohore*

## SHKOLLA & KOMUNITETI

*Niveli i shkollimit të të rinjve dhe nevojat e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit*

## REPORTAZH

### **45 vjet në udhën e dijes**

*45 Vjet në udhës e dijes, ishte titulli i veprimtarisë së zhvilluar nga gjimnazi “Themistokli Gërmenji” Korçë, me rastin e 45 vjetorit të çeljes së kësaj shkolle.*

*Nga takimi i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës zoti Myqerem Tafaj, me drejtues, mësues e maturantë të Tiranës*



<i>Përmajtja:</i>	<i>faqe</i>
<b>Editorial</b>	<b>1-2</b>
<i>MASH info&amp;veprimtari</i>	
<b>Risite e Maturës Shtetërore 2011 - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, bashkëbisedon me drejtues, mësues e nxënës të Tiranës</b>	<b>3</b>
<b>Ministri Tafaj, merr pjesë në ditën Informative mbi Programin e Shtatë Kuadër (FP7) të Bashkimit Evropian për kërkimin shkencor në fushën e Teknologjisë së Informacionit</b>	<b>3</b>
<b>Arsimi &amp; Reforma Mbështetja për autonominë në Arsimin Parauniversitar, sfidë dhe reformë bashkëkohore</b>	<b>4-6</b>
<b>Masteri - një sfidë që mund të fitohet</b>	<b>7-8</b>
<b>Suksese dhe arritje të Maturës Shtetërore</b>	<b>9</b>
<b>Mësuesi &amp; Nxënësi Orë Model Matematikë Kl.VI</b>	<b>11-12</b>
<b>Liritë dhe të drejtat themelore të Njeriut</b>	<b>13-14</b>
<b>Natyra e kualifikimeve kyç: Një analizë e kohës</b>	<b>15-16</b>
<b>Dhjetë këshilla për mësuesit</b>	<b>17</b>
<b>Arsimi &amp; Komuniteti Psiko-dëshmi 3 Imitimi i më të mëdhenjve, si përshtatje apo si sfidë.</b>	<b>18</b>
<b>Niveli i shkollimit të të rinjve dhe nevojat e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit</b>	<b>19-20</b>
<b>Më shumë kohë dhe kujdes edukimit të fëmijëve në familje</b>	<b>21-22</b>
<b>Traditë &amp; Kulturë Përvojë nga mësues nga Anglia. Një orë mësimdhënie ndryshe.</b>	<b>26-27</b>
<b>Dy tekste të Oxfordit të sjellë në shqip</b>	<b>28-29</b>
<b>Jeta dhe veprimtaria e një piktori</b>	<b>30-31</b>

## PËRVJETORËT nga Andon ANDONI

Por tjetër ide e përbashkuar me festat (paçim sa më shumë të tilla) na ngacmon të hedhim vështrimin tek një nga problemet e cekura së fundmi edhe nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj në takimin me drejtues të DAR dhe ZA; “Bëni sa më shumë miq të shkollës, figurat e shquara që kanë dalë prej saj dhe personalitete të jetës publike, artistë, shkencëtarë, politikanë, sportistë....Në këtë mënyrë shkolla do të gumëzhijë nga veprimtaritë” Dhe me të vërtetë, organizimi i veprimtarive të tilla, sa argëtuese dhe edukuese e mbresëlënëse, duhet të jetë jo vetëm një sjellje spontane dhe sporadike e shkollës sonë, por të mirëplanifikuara dhe organizuara përmes orëve dhe ditëve të aktiviteteve si të tilla, sidomos me nxënës dhe fëmijë të shkollave tona, por edhe me kolektivat e mësuesve dhe pjesë të komunitetit. Dhe në ditën festive të gjimnazit “Qemal Stafa” kishte mjaft syresh. Ajo ishte përpos qëllimit të saj përvjetor, edhe një justifikim i qëllimit të tillë si ditë veprimtarie edukuese dhe mbresëlënëse. Nxënësit takoheshin me mësues të brezave të shkuara, mësues të prindërve të tyre, edukatorë që jetonin me emocionin e ish -nxënësve të tyre. Aktiviteti u spostua nga shkolla në sallën e muzeut, e më pas, në Pallatin e Kulturës në një koncert të vetë nxënësve. Shkolla jonë ka shumë nevojë për të tilla veprimtari. Ata afrojnë, padyshim, miqësi mes nxënësve dhe fëmijëve. Japin modele dhe sjellje të adhuruara prej mësuesve të sotëm, “kandidatë” për të qenë nesër të mësuesit model të brezave që do vijnë në gjimnaz. Ndaj dhe festa në ditë të tilla të hapura është një sinjal i fortë për shkollën tonë drejt një shkollë miqësore, të gumëzhuar prej veprimtarish, me në qendër njerëzit e shquar të shoqërisë sonë, të urtët dhe të diturit, të shquarit dhe të suksesshmit.



# Ministri Tafaj, merr pjesë në ditën Informative mbi Programin e Shtatë Kuadër (FP7) të Bashkimit Evropian për kërkimin shkencor në fushën e Teknologjisë së Informacionit

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, z. Myqerem Tafaj, mori pjesë në ditën Informative mbi Programin e Shtatë Kuadër (FP7) të Bashkimit Evropian për kërkimin shkencor. Ministri Tafaj, theksoi se kjo Konferencë është një ndihmë e rëndësishme për zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e teknologjisë së informacionit në Shqipëri.

Në fjalën e tij, Ministri Tafaj u shpreh se investimi në përgatitjen e burimeve njerëzore të kualifikuara në fushën e IT-së është një faktor parësor për krijimin i një minimumi kritik të nevojshëm, për zhvillimin e këtij sektori në të gjitha dimensionet e tij në vendin tonë.

Ministri Tafaj theksoi se Programi ICT Work, pjesë e Programit FP7, është një mbështetje shumë e madhe për shkollimin e të rinjve në ICT, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe atij të biznesit. Ne duhet të investojmë në burimet njerëzore në mënyrë që të zhvillojmë biznesin e vogël, të mesëm dhe të madh në këtë fushë. Konferenca e sotme është një mundësi shumë e mirë për in-



formimin e grupeve kërkimore, pedagoqeve, doktorantëve, si dhe sipërmarrjeve që operojnë në fushën e ICT-së. Informacioni i plotë mbi këtë program do të shërbejë rritjes së numrit të aplikimeve të suksesshme, për projekte të kërkimit dhe transferimit të teknologjisë, nga institucionet dhe sipërmarrjet e vendit tonë në Programin e Shtatë Kuadër 7 (FP7) të Bashkimit Evropian.

## Risite e Maturës Shtetërore 2011

*Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, bashkëbisedon me drejtues, mësues e nxënës të Tiranës*

I pranishëm në takimin e analizës vjetore të DAR-Tiranë-Qytet, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, zoti Myqerem Tafaj, bashkëbisedoi me mësues, drejtues e nxënës të qytetit të Tiranës. Në fjalën e tij Zoti Tafaj u ndal në rezultate dhe ecurinë e Maturës Shtetërore 2010, duke veçuar punën e lavdërueshme që u krye në këtë drejtori që nga këshillimi i karrierës, në gjimnazet dhe shkollat e mesme të kryeqytetit, administrimin e procesit të provimeve dhe deri në shpalljen e rezultateve të maturantëve. Por, përpos kësaj gjendjeje, tashmë të njohur dhe të certifikuar në mbarë vendin, më tej Ministri u ndal dhe në hapat që do të hidhen për konsolidimin e mëtejshëm të Maturës Shtetërore të vitit shkollor 2010-2011.

Ajo do konsolidojë arritjet dhe standardet më të mira të viteve të fundit,- tha ministri Tafaj, -dhe do ketë disa risi:

1. Shkolla e mesme përfundon me **Diplomë të Maturës**, duke zëvendësuar dëftesën e pjekurisë. Çdo maturant që fiton katër provimet e Maturës Shtetërore, (dy të detyruara dhe dy me zgjedhje), pajiset me Diplomën e Maturës dhe ka të drejtë të vazhdojë studimet universitare. Diploma do të përmbajë notat e maturantit të katër viteve dhe rezultatet e katër provimeve të Maturës.

2. Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në përfundim të vitit shkollor në një sesion të vetëm. Nuk do të ketë sesion të dytë provimesh në vjeshtë. Çdo maturant mbetës, qoftë dhe në një nga provimet e detyruara apo me zgjedhje, ka të drejtën e riprovimit të lëndës/ve në vitin e ardhshëm shkollor.

3. Është shtuar numri i qendrave të vlerësimit të provimeve nga katër në gjashtë. Kjo garanton korrigjimin e testeve të provimit të së njëjtës shkollë nga i njëjti grup vlerësuesish dhe redukton kohëzgjatjen e korrigjimit të testeve të provimit.

4. Do të shihet mundësia e shkurtimit të kohëzgjatjes së zhvil-



limit të provimeve, 1.5 orë për çdo provim të detyruar dhe 3 orë për provimin e lëndëve me zgjedhje. Edhe testi i provimit do të hartohet në mënyrë të tillë, që të jetë i nivelit mesatar dhe plotësisht i realizueshëm brenda kohës së vënë në dispozicion për të gjithë nxënësit.

5. Është përsosur sistemi i këshillimit të karrierës dhe dhënies së informacionit për çdo maturant që dëshiron të vazhdojë studimet universitare.

6. Ka filluar që tani publikimi i manualeve informuese që u vijnë në ndihmë maturantëve.

7. Do të vazhdojë sistematikisht trajnimi dhe më pas certifikimi i korrigjuesve të testeve.

Në fund të takimit, ministri Tafaj shpërndau "**Manualin e Maturantit**" dhe bashkëbisedoi me nxënësit duke vënë theksin në hapat e rëndësishme administrative që do të hidhen për të ardhmen, duke kërkuar nga të rinjtë të tregojnë pjekuri dhe maturi në të gjitha hallkat e këtij procesi, që nga këshillimi i karrierës, plotësimi i formularëve dhe pjesëmarrja në provim, si elemente të rëndësishëm për vetë maturantët dhe shkollën tonë.

# Mbështetja për autonominë në Arsimin Parauniversitar, sfidë dhe reformë bashkëkohore

## 1. Autonomia në qeverisjen në arsim

Dr. Ndriçim Mehmeti/MASH

**Qeverisja në arsim**, veçanërisht lidhur me decentralizimin dhe dhënien e sa më shumë kompetencave në politikbërje, financim, të drejta ekzekutive etj., është një nevoja për t'u zhvilluar sipas standardeve të bashkëkohore.

Ndërsa ristrukturimi formal kah decentralizimi ka shënuar progres të dukshëm në disa sektorë, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, ritmet e decentralizimit të përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror drejt atij vendor për arsimin parauniversitar nuk kanë qenë të kënaqshme.

Kjo qeverisje duhet të rrisë nivelin e autonomisë si një parakusht për krijimin e një shërbimi arsimor më cilësor dhe më pranë komunitetit.

Faktorët pengues drejt realizimit në nivele të kënaqshme dhe të krahasueshme me përvojat bashkëkohore kanë qenë:

**Së pari**, Për shkak të një centralizmi të fortë të trashëguar nga e kaluara, mungonte lidhja e plotë e funksionale e shkollës me komunitetin si një detyrim demokratik për të siguruar një arsim të mirë për të gjithë. Kjo mangësi mënjanonte deri diku rolin që duhet të luante fuqia e familjes dhe karakteri social i komunitetit, për të përmbushur plotësisht përpjekjet për arsimim.

Pjesëmarrja e komunitetit jo vetëm është një mbështetje dhe nxitje për mësimdhënien por edhe një faktor nxitës dhe korrigjues për politikën që duhet të ndërmerren nga vetë shkolla për përmirësimin e shërbimit arsimor.

**Së dyti**, Mungesa e një bashkëpunimi bazuar mbi një strategji afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë mes pushtetit lokal dhe njësive të dekoncentruara të arsimit që janë Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore;

**Së treti**: Pjesëmarrja e pushtetit lokal dhe biznesit rajonal në financimin dhe mbështetjen e projekteve infrastrukturore në arsimin parauniversitar.

Gjithsesi duhet thënë që në fillim se kohët e fundit decentralizimit dhe autonomisë së Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore i është dhënë një përparësi e veçantë. Kjo ka të bëjë me një filozofi të re e cila, shtrihet që nga krijimi i kapaciteteve dhe organizmave në nivel qendror por edhe në nivel lokal.

Ndër masat e marra në nivel qendror drejt dhënies së autonomisë dhe kompetencave më të gjera Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore mund të veçojmë:

a- Krijimi një Drejtorie të Decentralizimit dhe Koordinimit Rajonal, që ka marrë përsipër pikërisht rritjen e autonomisë lokale dhe delegimin e përgjegjësive drejt Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore;

b- Dhënia e së drejtës së Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të prokuruar për nevojat e tyre pajisjen me laboratorë, mjete didaktike, regjistra etj.

c- Krijimi i kapaciteteve menaxhuese, më të mira përmes ristrukturimit të funksioneve të DAR/ZA;

d- Përzgjedhja që kanë mundësi të bëjnë DAR/ZA të organizmave trajnues për rritjen e kapacitetit profesional të mësimdhënësve;

e- Pjesëmarrja e shkollave në konkurrimin për grandet shkollore që jepen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës etj.

Në aspektin legjislativ, Ligji i ri i Arsimit Parauniversitar, për-

cakton qartësisht rolin gjithnjë e më të madh të pjesëmarrjes së pushtetit lokal në arsimim dhe bashkëpunimin dhe koordinimin me Drejtoritë Arsimore/Zyrat Arsimore dhe Ministrinë e Arsimit. Kështu ku flitet për rolin e Këshillit Rajonal të Arsimit Parauniversitar mes të tjerash është detajuar se:

Këshilli Rajonal këshillon Prefekturën, njësitë përkatëse bazë vendore dhe njësinë e dekoncentruar për:

- Strategjinë Lokale të Arsimit Parauniversitar;
- Zbatimin e reformave në arsimin parauniversitar;
- Projektbuxhetin lokal të arsimit parauniversitar;
- Aspekte të tjera të vendim-marrjeve arsimore me kërkesën e posaçme të Ministrit ose Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale ose kryetarit të bashkisë/komunës.

Pikërisht hyrja në fuqi e këtij ligji, zbatimi i tij në terrenin konkret besojmë se do të japi frytet e veta. Madje ky bashkëpunim mes organizmave politikbërës mund të shtrihet edhe në nivel rajonal mes shkollave të vendeve fqinjë, duke shkëmbyer dhe marrë një eksperiencë të vyer në drejtim të zbatimit të autonomisë lokale dhe të shkollës në veçanti.

Ky proces do të kërkojë forcimin e kapaciteteve menaxhuese, politikbërëse dhe vendimmarrëse për ti paraprirë zbatimit sa më efektiv të autonomisë.

## 2. Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikbërës, menaxhues dhe vendimmarrës.

Ky proces është një nga përparësitë në kuadër të Partneritetit Evropian, sipas të cilit kërkohen të merren një sërë hapash për realizimin e autonomisë, duke ndarë përgjegjësitë që vijnë nga pushteti qendror (Ministria e Arsimit dhe Shkencës) dhe duke zbritur deri në nivel lokal në Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore. Në "Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2009-2013", për të jetësuar decentralizimin në arsimin parauniversitar janë përcaktuar këto hapa:

• **Në nivel qendror**: Ristrukturimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve të varësisë duke ndërtuar një skemë të qartë menaxhimi me bazë performance. Tashmë ky objektiv mund të quhet i realizuar më ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë së Decentralizimit dhe Koordinimit Rajonal;

• **Në nivel rajonal**: Ristrukturimi i Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore me objektiv rritjen e kapaciteteve në ndihmë të shkollave. Tanimë Drejtoritë Arsimore Rajonale kanë një strukturë që tenton më shumë nga menaxhimi, politikbërja dhe administrimi, sesa vetëm evidentimi i problematikave dhe raportimi i tyre në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Në ligjin e ri të Arsimit Parauniversitar, në Nenin 76 për caktohet se:

Njësia arsimore e dekoncentruar (Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore) ka funksionet e mëposhtme për institucionet arsimore nën juridiksionin e saj:

a) Hartimi dhe zbatimi i strategjisë rajonale arsimore në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

b) Zbatimi i akteve nënligjore dhe udhëzimeve që Ministri lëshon për këto njësi të dekoncentruara;

c) Mbështetja e institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve arsimore.

d) Bashkëpunimi me njësitë bazë të qeverisjes përkatëse vendore në fushën e arsimit.

Për ti dhënë një frymëmarrje më të madhe vendimmarrjes në nivel lokal Neni 77 përcakton se:

- a) Drejtuesi i njësisë së dekoncentruar vlerëson performancën vjetore të drejtorit të institucionit arsimor sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria.
- b) Drejtori i njësisë së dekoncentruar rendit shkollat sipas një bashkësie treguesish të performancës të përcaktuara nga Ministria dhe të plotësuara nga DAR sipas politikave lokale të saj.
- c) Renditja e shkollave shpallet publikisht për shkollat dhe komunitetin shkollor

• **Në nivel shkollë:** Zbatimi i autonomisë shkollore, kërkon një autonomi gjithnjë e më të madhe veçanërisht në këto në fushat e:

- a) programeve të lëndëve,
- b) Mënyrës së financimit dhe përfitimit nga financime të të tretëve dhen donatorëve (për të cilat do të flasim edhe më poshtë)
- c) Përzgjedhjes së personelit mësimdhënës dhe atij ndihmës;
- d) Menaxhimit në nivel shkollë.

### 3. Përmirësimi i frytshmërisë së financimit në arsim përfshin disa drejtime:

- Rritja e mbështetjes financiare të arsimit bazë nga qeveria qendrore dhe lokale
- Përmirësimi i skemës së financimit i mbështetur në numrin e nxënësve, zvogëlimi gradual deri në eliminimin e dallimeve rajonale të trashëguara arsimore, ekonomike e sociale dhe racionalizimi i shkollave bazuar në prirjet e ndryshimeve demografike.
- Sigurimi i rritjes së të ardhurave për arsimin nëpërmjet përjashtimit nga taksat të investimeve jopublike sidomos në infrastrukturën arsimore
- Zgjerimi e forcimi i autonomisë së shkollave shpie në rritjen e interesit të aktorëve për shkollën.

### 4. Koncepti dhe zbatimi i autonomisë në nivel shkollë

Në sistemin e decentralizuar, shkollave do t'u kërkohej të marrin përgjegjësi të mëdha në planifikimin, menaxhimin dhe përmirësimin cilësor të shërbimeve që ato sigurojnë. Aktualisht, jemi në fazën e përgatitjes dhe trajnimit të strukturave në nivel shkollë për të arritur një përshtatshmëri gjithnjë e më të mirë me kërkesat që mbartin zhvillimet e reja në këtë fushë. Gjithsesi nuk mund të lëmë pa përmendur disa hapa pozitivë dhe hapësira që është krijuar shkollave në fushën e :

- a) Menaxhimit të shkollës.** Në vitin 2007, një Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës e kthente drejtorin në rolin e një menaxheri të shkollës. Në këtë kuptim jo vetëm që rrit rolin e tij në vendimmarrje por i jepte mundësi të trajnohej në fushën e rritjes së kapaciteteve vetë administruese të shkollës;
- b) Përzgjedhja e teksteve shkollore dhe literaturës në ndihmë të procesit mësimdhënës.** Tanimë Ministria e Arsimit vetëm certifikon tekstet që do të përdoren në arsimin parauniversitar. Përzgjedhja e tyre bëhet drejtpërdrejtë nga mësimdhënësit në shkolla. Kjo procedurë i jep jo vetëm një autonomi më të lartë në fushën e vendimmarrjes akademike mësuesit, pro e bën atë më të përgjegjshëm në detyrimin për rritjen e cilësisë në mësimdhënie;

#### c) Autonomia e mësuesit shtrihet në këto fusha:

- Një shkallë e mjaftueshme lirie profesionale e mësuesit në përvijimin e kurrikulës me bazë shkollë;
- Përgjegjshmëri e institucionalizuar për arritjet e nxënësve,
- Hapësirë e mjaftueshme për projekte shkollore në dobi të zhvillimit profesional.

**d) Zbatimi i kurrikulës së re të arsimit parauniversitar në nivel shkollë.** Me ndryshimin e arsimit të detyruar nga 8 në 9 vjet, kurrikula e re parashikon një përqindje të lartë që vendoset në dispozicion të mësuesit. Nga ana tjetër shkollës i jepet i drejta të hartojë module dhe kurrikula që i shërbejnë

zhvillimit të arsimit në nivel rajonal. Kjo i jep mundësi shkollës që të hartojë vetë politika arsimore duke e rritur në një shkallë akoma më të lartë autonominë e saj dhe duke ndikuar në përmirësimin gjithnjë e më të madh të shërbimit arsimor.

**e) Në fushën e trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve.** Drejtorja e shkollës ka detyrimin të hartojë nevojat që ajo për trajnimin e mësuesve të saj në fusha të ndryshme të edukimit. Këtë kërkesë ajo ja përcjell Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Zyrës Arsimore. Mandej Drejtorja Arsimore Rajonale dhe Zyra Arsimore harton një kalendar të kualifikimit dhe përzgjedh vetë mes ofertave të ardhura për trajnim nga subjekte shtetërore dhe private që veprojnë në fushën e trajnimit në arsimin parauniversitar.

**f) Marrëdhëniet mes shkollës dhe komunitetit.** Në të kaluarën, komunitetet lokale dhe prindërit janë përfshirë shumë pak në planifikimin e veprimtarive shkollore dhe zgjidhjen e problemeve eventuale që shoqëronin procesin mësimor. Me ndryshimet që janë bërë në legjislacionin e ri e veçanërisht në Udhëzimin e posaçëm për "Ngritjen e Bordeve të shkollës dhe funksionimit të tyre", ky bashkëpunim është rritur edhe më tej.

**g) Ndihma e projektit Cilësi dhe Barazi në Arsim.** Projekti Cilësi dhe Barazi në Arsim i cili operon prej disa vitesh, ndër shumë objektiva ka edhe autonominë shkollore veçanërisht në fushën e autonomisë financiare, të cilën do ta shtjellojmë më poshtë.

### 5. Realizimi i vërtetë i autonomisë shkollore nis nga autonomia financiare.

Realizimi i autonomisë shkollore në radhë të parë kërkonte ndryshim të legjislacionit të arsimit parauniversitar. Legjislacioni duhej të ishte i atillë që të lejonte pjesëmarrjen e disa aktorëve si:

- a- Pushtetit lokal
- b- Biznesi privat
- c- Prindërve
- d- Donatorëve vendas dhe të huaj që veprojnë në fushën e arsimit

Kjo kërkesë e kohës është mishëruar në Draft-Ligjin e ri të Arsimit Parauniversitar. Ligji i ri do të parashikoj detyrimet dhe të drejtat e aktorëve të mësipërm.

**A - Pushteti Lokal.** Qeverisja vendore në arsimin parauniversitar parashikohet të ketë për mision të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë fëmijët parashkollorë dhe nxënësit në sistemin



arsimor parauniversitar në territorin nën juridiksionin e saj. Funksionet arsimore të qeverisjes vendore më specifiku do të jenë:

- Sigurimi i godinave, territorit dhe kushteve materiale për realizimin e shërbimit arsimor sipas standardeve të miratuara.
- Planifikimi dhe buxhetimi për arsimin në nivel vendor;
- Hapja dhe mbyllja e institucioneve arsimore parauniversitare në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
- Mbështetja e institucioneve arsimore për të rritur cilësinë e shërbimit arsimor nëpërmjet fondeve financiare për:
- Trajnimin e punonjësve të institucioneve arsimore,
- Zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje,
- Shtesën në pagë për punonjës arsimorë,
- Ndihmë të posaçme për nxënësit në nevojë etj.
- Mbikëqyrja e institucioneve arsimore përkatëse për aspekte të cilat u përkasin funksioneve të saj arsimore;
- Bashkëpunimi me njësinë përkatëse arsimore të dekoncentruar.

**B - Biznesi privat. Ndihma e biznesit privat mund të jetë e shumanshme.** Biznesi mund të kontribuojë duke:

- Dhënë ndihmë financiare në formë donacionesh;
- Kontributi në përmirësimin e infrastrukturës shkollore;
- Punësimi i të rinjve në bizneset e tyre etj.

**C - Roli i Bordit të prindërve.** Me Ligjin e ri të Arsimit Parauniversitar Bordi i prindërve në institucionet arsimor ka për mision të përfaqësojë interesat e fëmijëve parashkollorë ose nxënësve dhe prindërve të tyre në institucionin arsimor. Ligji parasheh këto detyrime të Bordit:

- Të marrë pjesë në hartimin e synimeve, objektivat afatmesme dhe vjetore të institucionit arsimor dhe t'i miratojë ato;
- Të miratojë planin financiar të institucionit arsimor dhe të mbikëqyrë realizimin e tij;
- Të monitorojë përmbushjen e objektivave vjetore të institucionit arsimor;
- Të sigurojë fonde financiare për institucionin arsimor;
- Të mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe, në veçanti kundrejt çfarëdo forme të diskriminimit, dhunës dhe abuzimit kundrejt tyre;
- Të mbrojnë të drejtat e prindërve kundrejt çfarëdo forme të diskriminimit dhe abuzimit brenda institucionit arsimor;
- Të raportojë para komunitetit të prindërve të institucionit

**D - Donatorëve vendas dhe të huaj që veprojnë në fushën e arsimit.** Ligji parashikon se:

- Individët, familjet, organizatat, kompanitë private (vendase ose të huaja) që;
- sponsorizojnë ose japin donacione për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të një institucioni arsimor publik.

**6. Mbledhja e të ardhurave nga shkollat.** Sikundër e përmendëm edhe më lart kyçi i suksesit drejt autonomisë shkollore është padyshim autonomia financiare. Kur flet për lirinë filozofi Izajah Berlin thotë: "Një njeri nuk mund të jetë i lirë pa lirinë ekonomike dhe mirëqenien e tij individuale". Duke e shtrirë këtë këndvështrim drejt shkollës, padyshim që mbledhja e fondeve prej saj dhe shpenzimi në të mirën e cilësisë në arsim do të bënte të mundur përfitimin në realitet të autonomisë.

Për këtë arsye Ligji i kushton një vëmendje të madhe kësaj çështje që deri më tash ishte lënë në spontanitet të plotë. Madje mbështetja financiare përfshin jo vetëm institucionet publike por edhe ato private.

**A - Bordi i institucionit arsimor dhe drejtori e i tij** lejohen të mbledhin fonde financiare nga sponsorë ose donatorë.

Institucionit arsimor siguron fonde financiare duke dhënë:

- me qira mjedise ose kryer shërbime për të tretët.
- Institucioni arsimor i jep mjediset me qira ose kryen shërbime në mjediset e tij, pa cenuar mbarëvajtjen e procesit mësimor, pasi siguron lejen e qeverisë përkatëse lokale.
- Përdorimi i fondeve të tilla financiare i nënshtrohen kontrollit për mënyrën e sigurimit dhe efektivitetit të përdorimit.

**B - Përdorimi i fondeve financiare të siguruara nga institucioni arsimor**

- Fondet e mbledhura nga shkolla përdoren vetëm për përmirësimin e kushteve të nxënësve të shkollës.
- Nuk lejohet që të jepen mjedise me qira apo për shërbime kur pengohet zhvillimi normal i kurrikulës dhe i veprimtarive jashtë-kurrikulare.

**C - Ndarja e fondeve financiare të siguruara nga institucioni arsimor**

- Institucionet arsimore publike lejohen të përdorin 100% të fondeve të dhuruara nga donatorë ose sponsorë, institucione ose individë, dhe 75% të të ardhurave të marra nga qiratë e mjediseve të institucionit ose shërbimet për të tretët në mjediset e institucionit.
- 25% e të ardhurave të mbledhura nga institucioni arsimor i transferohen njësisë përkatëse bazë të qeverisjes vendore për investime në infrastrukturën e institucioneve arsimore.

**D- Mbështetja financiare e arsimit privat**

- Qeveria qendrore mbështet financiarisht veprimtari atë institucion privat që plotëson kushtet e mëposhtme:
- Ka statusin e institucionit jofitimprurës;
- Ka të paktën 5 vjet që funksionojnë si institucion arsimor;
- Është klasifikuar së paku dy herë ndër 10 shkollat më të mira të vendit për arritjet e nxënësve në nivelin përkatës arsimor.

**7. Rekomandime:**

Rritja e autonomisë dhe kalimi i kompetencave nga pushteti qendror në atë lokal duhet të shoqërohet me:

- Krijimin e kapaciteteve të mira menaxhuese në nivel lokal;
- Rritjen e pjesëmarrjes së pushtetit lokal në shërbimin arsimor në territorin që ai mbulon;
- Rritjen e investimeve të pushtetit lokal në drejtim të infrastrukturës shkollore;
- Rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit të prindërve në mbarëvajtjen e shkollës;
- Pjesëmarrje e gjerë e biznesit si një partner me aftësi të mira menaxhuese dhe financuese në drejtim të shërbimit arsimor;
- Rritja e kompetencave ekzekutive të njësisë të dekoncentruara të arsimit (Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore);

**8. Përfundimi nga taksat**

Shkollat duhet të inkurajohen që të gjejnë burime alternative financimi. Për të rritur kontributin bamirës të publikut, të gjitha financimet alternative duhet të përjashtohen nga taksat, në mënyrë që çdo qindarkë e dhuruar të përdoret për përmirësimin dhe mbështetjen e cilësisë në arsim.

Gjithashtu, OJF-të, mësuesit dhe nxënësit, të cilët blejnë materiale mësimore si kompjuter etj., duhet të përjashtohen nga taksat. Është e nevojshme që të thjeshtohen rregullat për përjashtime të tilla, në mënyrë që njerëzit të financojnë më shumë në këtë fushë.

Duhet të rishikohen praktikat aktuale të sigurimit të të ardhurave nga shkollat, si për taksimin e tyre, ashtu edhe për vendimet përkatëse të bashki/komunave.

Shkolla duhet lejuar që të rrisë pavarësinë në përdorimin e të ardhurave të krijuara nga pajisjet e veta dhe mjediset si dhe nga punonjësit që angazhohen jashtë orarit të punës.

# Masteri - një sfidë që mund të fitohet

*E vlerësoj shumë atë çka mësova nga ky master. Kam shumë vjet në arsim, por gjatë këtij viti e pashë arsimin nga një tjetër këndvështrim, mora njohuri të reja, që në jetën dhe punën e përditshme të tij mësuesi i nënvleftëson, i anashkalon. Mësuesi, mendoj unë, ka informacion paksa të cunguar mbi ligjshmërinë, mbi Dispozitat Normative që janë bazat e rregullimit të Sistemit Arsimor Parauniversitar.*

Sapo jam diplomuar në një master profesional dhe ndjehem e kënaqur dhe që ia dola. Kalova një vit të vështirë, të lodhshëm, por edhe mjaft të bukur që më mësoi shumë gjëra të reja dhe më ktheu impresionet e të qenit student, krahas studentëve të tjerë, disa prej të cilëve ishin pothuaj në moshën e vajzës sime. Të qenët pranë tyre, përgatitja, detyrimet shkollore, garimi tregoi se edhe ne, nënat e tyre, mund t'i konkurrojmë në produktet intelektuale, madje me shumë dinjitet.

Jam mësuese e ciklit të ulët e diplomuar në vitin 1985 dhe, vitin e kaluar, vendosa të plotësoj shkollimin tim me një Master të Nivelit të Parë, tashmë Master Profesional në fushën e drejtimit dhe administrimit të arsimit, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Tiranë. Kishin kaluar shumë vite nga koha e të qenit në bankat e shkollës si studente dhe fillimi për mua ishte mjaft i vështirë. Duhet të lija pak pas dore të gjitha angazhimet e mia si nënë, bashkëshorte dhe duhet t'i kushtohesha me shumë përkushtim detyrës së studentit.

Prej tre vitesh kisha aplikuar pranë Fakultetit të Shkencave Sociale për Master në fushën e pedagogjisë, por përgjigja po vononte për shkak të riorganizimit të arsimit të lartë. Më së fundi u shpall vendimi për rifillimin e masterave, por tashmë me një tjetër organizim, i rivendosur në formatin e Sistemit të Bolonjës. A duhet ta ndiqja unë apo jo, ia vلنتë? Edhe vetë punonjësit në fakultet nuk e kishin shumë të qartë këtë mënyrë të re funksionimi. Mes shumë dilemash bëra një aplikim.

Listimi më kishte nxjerrë shumë pranë kreut të listës. A do të mund ta ruaja unë cilësinë në përgatitje, a do të mund të ecja me hapin e këtij brezi të ri që po rritet në kohën e internetit? Të gjitha këto më shqetësonin dhe më bënin shpesh të mendoja se i kisha hyrë një rrugë të vështirë, të papërballueshme. Megjithatë po ecja nëpër të pak e nga pak, jo e bindur se po bëja atë çka duhej.

Studimet filluan në fillim të nëntorit dhe tashmë isha paksa më e qetë me nxënësit

Anila JORGI - Shkolla 9-vjeçare "Skënder Çaçi" - Tiranë

e klasës së parë që kisha në shkollën time, në punën e përditshme. Nga ana tjetër, në shtëpi përballesha me ngarkesën e një maturanteje që përgatitej të konkurronte edhe për arkitekturë dhe të një nxënësi të vitit të parë të gjimnazit, i cili ishte në periudhën "më të mirë" të adoleshencës së tij. Kësaj i shtohet edhe përkujdesja për gjyshin e tyre, që gëzon shëndet të plotë në moshën 93 vjeçare. E gjithë kjo ngarkesë fizike dhe mendore më tërhiqte më shumë prapa se sa përpara. Bashkëshorti dhe fëmijët më nxitnin duke premtuar se do të më ndihmonin me se të mundnin dhe, në të vërtetë, pa ata të tre nuk do t'ia kisha dalë kurrësi. Prindërit e mi nga ana tjetër edhe gëzoheshin për këtë hap që po ndërmerrja dhe ndjenin keqardhje për ngarkesën e madhe që do të kisha. Ndihma e tyre më ndoqi dhe më ndjekë ashtu, siç më ka ndjekur që ditën që kam lindur.

Edhe pse vendosa të filloj studimet mendova se ato do të zhvilloheshin disa ditë të javës, ose vetëm në fundjavë, por organizimi i ri ofronte studime me kohë të plotë si studime të rregullta universitare. Mësimi u vendos të zhvillohej çdo pasdite (gjë që më leverdiste mjaftueshëm) nga e hëna në të premte. U futa në rrjedhën universitare dhe ndiqja me kuriozitet çdo moment me këmbëngulje për të mos humbur asgjë nga organizimi, nga leksionet, nga gjithçka e re.

Informacioni shtohet nga ditë në ditë. Në çdo lëndë pedagogët ishin me përvojë të gjerë akademike dhe mjaft të përgatitur, mënyra e komunikimit të tyre të impononte respekt dhe përgjegjësi më të lartë. Çdo lëndë, përveç se provimin përfundimtar, do të përfshinte edhe 2 ose 3 detyra kërkimore gjatë shtrirjes së saj. Pikërisht, kjo ishte e reja më e dallueshme në krahasim me vitet e mëparshme të shkollimit tim, jo për faktin e përgatitjes së detyrës, por për mënyrën e prezantimit të saj para të gjithëve, në auditor, me mjetet e reja të teknologjisë. Për brezin e ri kjo që po shpreh unë, ndoshta nuk përbën vështirësi,



sepe e kanë të përditshme të qëndruarit me orë të tëra para kompjuterit, por për mua dhe për shumë nga bashkëmohatarët e mi, të bën të stepesh një moment.

Kjo ishte një Sfidë ! Duhej kaluar dhe kaloi mjaft mirë, sa që nga fundi i vitit, u bë i domosdoshëm dhe u kthye në kënaqësi prezantimi me projektor dhe argumentimi nëpërmjet punimeve të bëra në programe të ndryshme kompjuterike.

Këtij organizimi të ri i shtohet edhe puna e përbashkët në grup, të cilën, ne mësuesit, e propagandojmë dhe e aplikojmë shpesh me nxënësit. Të përfshihesha në punët në grup ishte një tjetër sfidë. Kjo sepse unë kisha rastin të përfitoja për shkak të ngarkesës së madhe që kisha. Në të vërtetë, s'ishte aspak kështu. Në asnjë moment nuk desha të përfitoja nga puna e të tjerëve, por trashëgoja një dobësi nga e kaluara ose për shkak të karakterit tim; doja që çdo gjë ta shikoja, lexoja, kontrolloja e ta kaloja në dorë, duke u kujdesur se mos i ofendoja shoqet e mia të grupit. Në të vërtetë, edhe pse e stërmundoja veten, kuptova se puna në grup të mëson shumë, të pasuron në ide, gjykime të jep më shumë zgjidhje, të korrigjon. Puna në grup më bëri të kuptoj që secili ndihmon sipas mënyrës së tij, secili ofron diçka dhe, pak e nga pak, ndërtohet në fund një punë e bukur me vlera.

Dhënia e provimeve vuri në provë të fortë aftësitë e memories sime paksa të ngarkuar dhe të larguar nga studimi. Ishte një ndër sfidat më të vështira të vitit, por marrja e rezultateve në fund të secilit provim më shpërbleu lodhjen e netëve të gjata pa gjumë.

Dëshiroj të vë në dukje mënyrën e vlerësimit të lëndës, jo me riprodhim të materialit teorik, por nëpërmjet punimeve kërkimore në dy apo tri detyrat e dhëna gjatë vitit të planifikuara, me detaj nga pedagogët e lëndëve "Vlerësimi në Arsim" Prof. Dr. N. Mita dhe "Ndryshimet dhe Risitë në Arsim" nga Prof. B. Musai. Këto detyra

kërkonin kombinim të dy anëve edhe asaj teorike të dhëna në leksione, të anës praktike dhe të kërkimit shkencor.

E vlerësoj shumë atë çka mësova nga ky master. Kam disa vite të konsiderueshme në arsim, por gjatë këtij viti e pashë arsimin nga një tjetër këndvështrim, mora njohuri të reja, që në jetën dhe punën e përditshme të tij mësuesi i nënvleftëson, i anashkalon. Mësuesi, mendoj unë, ka informacion paksa të cunguar mbi ligjshmërinë, mbi Dispozitat Normative që janë bazat e rregullimit të Sistemit Arsimor Parauniversitar. Lëndët e përfshira në këtë master si "Vendimmarrja në Arsim" apo "Analiza e Politikave në Arsim" ndihmojnë drejtuesin të marrë vendime dhe të krijojë një vizion për shkollën që ai drejton, njohuri që kur je nga pozicioni i mësuesit as që i mendon.

Masteri i titulluar "Drejtimit Administrim Arsimi" jep një formim të përgjithshëm mbi drejtimin e shkollës, të nxit të vlerësosh punën e drejtuesit për shkak të rolit të liderit që ai duhet të realizojë dhe të ngarkesës që ai merr përsipër. Gjatë këtij masteri unë mora informacion mjaft të gjerë rreth mënyrës së drejtimit të shkollës nëpërmjet lëndëve të përzgjedhura me mjaft kujdes nga hartuesit e tij. Por do të veçoja midis tyre një lëndë që ndoshta s'lidhet me drejtimin e shkollës drejtpërdrejt, pikërisht "Metoda Kërkimore në Edukim", lëndë që është mjaft e nevojshme për një punë cilësore në përgatitjen dhe paraqitjen akademike të punëve kërkimore, e cila ka munguar në vitet e shkollimit tim të mëparshëm.

Së fundi, edhe pse nuk i rendita ndoshta të gjitha mbresat, do doja të bëj një ftesë për të gjithë bashkëmohatarët e, sidomos për femrat, të mos ndalen asnjë çast nga dëshira për të provuar të studiojnë në një fushë të re a në një shkollim të ri. Asnjëherë nuk është vonë, asnjëherë mos u ndalni edhe pse ngarkesa e përditshme duket se nuk ua lejon, keni për t'ia dalë. Unë ia dola dhe ndjehem shumë e kënaqur.



# Suksese dhe arritje të Maturës Shtetërore

Zhvillimi i Maturës Shtetërore për vitin 2010, në gjimnazin “ Dhaskal Todhri “, Elbasan u përgatit dhe u zhvillua konform Udhëzimeve të MASH dhe rregullores “ Për provimet e Maturës Shtetërore »

Në këtë kuadër u ngrit komisioni i Maturës 2010 dhe ekipi i “ Këshillimit të Karrieres” të cilët kanë funksionuar rregullisht gjatë gjithë kohës së përcaktuar në Rregulloren e provimeve. Në shkollë u ngrit këndi “Matura Shtetërore 2090-2010”. Në të u afishuan të gjitha degët e universiteteve shtetëror dhe private, koeficientet e çdo dege dhe lëndët. U afishuan edhe piket minimale të fituara për çdo degë.

U bë një punë e mirë nga mësuesit kujdestarë për mënyrën e llogaritjes së pikëve, sipas notave të marra nga nxënësit. Gjatë kësaj kohe nxënësit, në bisedë me mësuesit edhe me prindërit e mjedisin shoqëror, krijuan një ide më të plotë të sistemit MERITË - PREFERENCË. Tashmë, nxënësit tanë, sipas dëshirave, vinin në ekuivalencë edhe meritën, sipas pikëve. Ky ndërgjegjësimit ishte faza e parë e përgatitjes për provimet.

Faza e dytë, në mënyrë intensive filloi në muajin mars 2010, ku stafi i mësuesve të lëndëve letërsi/ gjuhë shqipe dhe matematikë, por edhe ai i lëndëve të përzgjedhura nga nxënësit morën programet orientuese dhe filluan zbatimin e tij në klasat ku jepnin mësim. U bë detajimi për çdo kapitull dhe filloi përsëritja paralele.

Gjatë përsëritjeve të kushtuar vetëm provimeve të Maturës Shtetërore, sipas Udhëzimit të MASH, u organizua me orar të rregullt konsultime me nxënësit dhe u punuan tezat e rena në vitet e kaluara.

Si rezultat i një pune të tillë, nxënësit u përgatitën më mirë për provimet si nga ana shkencore, por edhe nga ana psikologjike. Dhe rezultatet nuk munguan. Kështu, në lëndën letërsi/ gjuhë shqipe kalueshmëria 100% dhe me

notë mesatare 8,06. U morën 8 nota dhjeta, 75 nota nënta, 53 nota teta, vetëm 2 nota pesa

Ne matematikë: kalueshmëria 100% dhe nota mesatare 8. U morën 20 nota dhjeta, 33 nota nënta, 40 nota teta dhe vetëm 5 nota pesa

Edhe në lëndët me zgjedhje shkolla pati sukses. Kalueshmëria 100% dhe me nota mesatare nga 6,9 e deri 8,04



Shpëtim SULANJAKU  
Drejtor i gjimnazit “Dhaskal Todhri” Elbasan

Mënyra e korigjimit të provimeve, këtë vit, nga komisionet e korigjimeve, me dy korigjues të pavarur dhe zgjidhja e mospërputhjeve me një të tretë ishte gjetja më e goditur që MASH bëri për vlerësimet. Kjo mënyrë vlerësimi, bëri

që nga 214 nxënës maturantë të shkollës, vetëm 3 të paraqitnin ankesa për rivlerësim dhe këta, pas rikorigjimeve, morën të njejtën notë.

**Si rezultat i këtyre përfundimeve 100% e maturantëve fituan të drejtën e vazhdimit të studimeve në universitete të ndryshme.**

Është pozitive se 88 maturantë fituan preferencën e parë të përzgjedhur prej tyre dhe 33 fituan në preferencën e dytë. Kjo tregon se si rezultat i punës për të sqaruar mekanizmin MERITE - PREFERENCË,

nxënësit e vlerësuan mirë meritën e tyre, sipas preferencës.

Sivjet, 46 maturantë nga shkolla “ Dhaskal Todhri” kanë fituar në degët më të preferuara.

Këto suksese janë merite e tërë stafit të mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e studiojnë në këtë shkollë, por edhe të prindërve të tyre që vazhdimisht mbështesin punën e fëmijëve të tyre, por edhe të shkollës.

Është e dukshme suksesi i Maturës Shtetërore në **eliminimin e korrupsionit** për regjistrimet në universitete.

Sivjet nuk ka patur asnjë ankimim për degën e fituar. DAR dhe drejtorja e shkollës ka mbajtur gjithnjë në dijeni çdo nxënës për rezultatet, nëpërmjet Librit të Transparencës.

Tashmë, **po ndërgjegjësohet edhe i fundit se rrugën e universitetit e ke të hapur, por atë duhet ta meritosh.** Është kjo një nga motivet që duhet të nxisë nxënësit dhe po i nxit që të mësojnë gjatë tre viteve të gjimnazit.

Drejtorja e shkollës sonë, mbështetur nga i tërë stafi i mësuesve dhe i prindërve, ka hartur planet e punës që këto rezultate të shkollës tonë të konsolidohen më tej, në vitet në vijim.

Motoja jonë është: **Ta matim punën tonë, jo vetëm me kalueshmërinë e notën mesatare, por edhe me suksesin e nxënësve maturantë në preferencat e tyre në universitete.**

# Roli i mësuesit për një mësimdhënia cilësore

*Shpeshherë kolegët, por dhe unë jemi gjendur përballë një problemi në orën e mësimit. Pasi kemi shpjeguar, kemi pyetur, zhvilluar punë të pavarur e vlerësuar, në fund kemi konstatuar se rendimenti minimal i orës së mësimit nuk është ai që prisnim. Sipas nesh, gjithçka e kemi bërë mirë, por rezultati nuk ka qenë ai që prisnim.*

*Pyetja që shtrohet është:*

*-Ç'duhet të bëjmë për të arritur cilësi në arritjen e objektivave mësimorë?*

*-Mos, vallë, nxënësit tanë nuk punojnë aq sa duhet, apo ne, mësuesit, nuk japim maksimumin në klasë?*

Një mësues i mirë duhet që, së pari, të hulumtojë tek vetja për të konstatuar dhe diagnostikuar problemet dhe pse jo edhe defektet në punën e tij përgatitore dhe atë të zhvilluar në klasë. Dhe përgjigjen e gjen duke vështruar në atë se sa produktive është mësimdhënia dhe nxënia e zhvilluar nga ai.

Për të arritur një mësimdhënie cilësore, mësuesi duhet të ketë objektivat e tij që mund të jenë:

## 1. Qartësia në mësimdhënie

Kjo do të thotë që mësuesi duhet të jetë i qartë në paraqitjen e mësimit në klasë duke:

- paraqitur çështjet mësimore të kuptueshme për nxënësit,
- përshkruajë dhe shpjegojë qartë konceptet nxënësve duke ndjekur një linjë logjike hap pas hapi.
- folur në mënyrë të qartë e të pranueshme me fjalë të thjeshta për nxënësit.

Në fakt jo të gjithë mësuesit janë në gjendje të komunikojnë qartë me nxënësit e tyre. Qartësia është një sjellje komplekse e mësuesit dhe është e lidhur me organizimin e përmbajtjes, familjarizimi me mënyrat e mësimdhënies si dhe mënyra e paraqitjes së njohurive.

## 2. Llojshmëria në mësimdhënie.

Që mësuesi të jetë produktiv duhet të jetë i larmishëm dhe për këtë duhet t'i japë rëndësi të pyeturit. Në orën e mësimit duhet të bëhen pyetje të shumta dhe të integruara natyrshëm ato krijojnë një variacion të këndshëm dhe të kuptimshëm. Prandaj mësuesit duhet të zotërojnë artin e të pyeturit duke njohur llojet e pyetjeve sipas niveleve. Një aspekt tjetër i mësimdhënies është përdorimi i materialeve për të nxënë, pajisjeve, vendosja e punimeve të nxënësve në mure e raftë, përdorimi i mirë i hapësirës fizike të klasës duke ndikuar kështu, në llojshmërinë e mësimdhënies, në rezultatet e nxënësve dhe përfshirjen e tyre në procesin e të nxënësve.

## 3. Orientimi në detyrë.

Ka të bëjë me kohën që duhet ti kushtojë mësuesi detyrës për mësimdhënien e temës apo të çështjeve të reja të mësimit. Sa më shumë kohe t'i kushtohet detyrës për mësimdhënien e temës, aq më shumë mundësi do të kenë nxënësit për të nxënë. Mësuesi duhet të përcaktojë saktë kohën që do t'i duhet për metodat që do të përdorë për dhënien e mësimit të ri, për pyetjet që do t'u drejtojnë nxënësve, për veprimtarinë e pavarur të tyre, për të menduar në mënyrë kritike, koha që duhet për të organizuar

**Krenar MEROLLI**

**Drejtor i Shkollës 9-Vjeçare/ Shushicë - Elbasan**

nxënësit për të nxënë. Në fund duhet të llogaritet koha që duhet për të vlerësuar shkallën e të nxënësve. Të gjitha këto pyetje janë të lidhura me materialin që paraqitet, ose vlerësohet. Nxënësit duhet të përgatiten për të nxënë në mënyrë që ky proces tu japë kënaqësi.

## 4. Përfshirja në procesin e të nxënësve.

Mësuesi nuk duhet të harrojë që përfshirja e nxënësit në procesin e të nxënësve është përcaktuese në lidhje me kohën e të nxënësve në mësim dhe e lidhur drejtpërdrejtë me rezultatin e nxënësve. Në dallim nga koha që i kushtohet mësimdhënies është dhe koha që i duhet nxënësit për të nxënë. Kjo quhet koha e përfshirjes aktive në të nxënësit e materialit. Sa më shumë të jetë nxënësi i përfshirë në të dy kohët, aq më i madh do të jetë rezultati në të nxënësit.

## 5. Shpallja e suksesit të nxënësve.

Kjo ka të bëjë me shkallën e të kuptuarit të detyrave dhe saktësinë në plotësimin e detyrave, ushtrimeve, testeve etj. Aspekti kryesor lidhur me orientimin e nxënësve në detyrë është vështirësia e materialit të ri. Niveli i vështirësisë ka të bëjë me shkallën e të kuptuarit saktë të ushtrimeve dhe detyrave. Këto tre nivele të vështirësisë janë si me poshtë:

Sukses i plotë: Nxënësi kupton detyrën dhe mjaft rrallë bën gabime që vijnë nga pakujdesia.

Sukses i pjesshëm: Nxënësi kupton në mënyrë të pjesshme por bën disa gabime të rënda.

Sukses i ulët: Nxënësi nuk e kupton fare detyrën. Përvoja tregon që orientimi në detyrë dhe shkalla e përfshirjes së nxënësve janë të lidhura ngushtësisht me shkallën e suksesit të nxënësve. Kërkimet e viteve të fundit e kanë shtrirë dhe më tej ndikimin e këtyre faktorëve tek mësimdhënia, për shprehitë e të menduarit të nxënësve.

Përvoja tregon se shumë mësues sidomos të rinj nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur të nxënësve çka është thelbësore për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të shprehive të zgjidhjes së problemit dhe mendimit kritik. Është e rëndësishme që mësuesit të planifikojnë dhe realizojnë mësimin, i cili i kapërcen kufijtë e suksesit të pjesshëm të nxënësve drejt suksesit të plotë dhe e nxit nxënësin të shkojë përtej informacionit të dhënë.

**Duke patur mirë parasysh drejtimet e mësipërme në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të çdo ore mësimi, mësuesi do të marrë gjithmonë arritjet që pret nga nxënësit e tij.**



# Orë Model

Lënda: MATEMATIKË

Klasa : VI -b

Tema : PËRQINDJA

**Objektivat:** Nxënësit në fund të orës së mësimit me temë “ PËRQINDJA” të jenë në gjendje :

**N. bazë (1-)** Të kthejnë thyesën dhjetore në përqindje.

**N. mes (2-)** Të kthejnë numrin dhjetor në thyesë dhjetore dhe në përqindje dhe përqindjen në thyesë dhe numër dhjetorë.

**N. lartë. (3-)** Të gjejnë % e një numri natyrorë, një thyesë me emërues të çfarëdoshëm.

**(4-)** Të gjejnë pjesën kur jepet e tëra dhe të gjejnë të tërën kur jepet pjesa.

**Mjetet e punës:** libri i matematikës, tabak me kllastera rreth %, thyesave.

**Konceptet kryesore:** Nr. Natyror, nr. dhjetorë, thyesë, përqindje.

**Struktura e orës mësimore:**


Struktura e mësimit			
Fazat e strukturës	S strategjitë mësimore	Veprimtaritë e nx. O	rganizimi i nx.
<b>Parashikimi</b> (përgatitja për të nxënësit)	Marrëdhëniet pyetje N përgjigje	dërtimi i shprehive	Punë me gjithë klasën
<b>Ndërtimi i njohurive</b> (përpunimi i përmbajtjes)	Mbajtja e strukturuar e shënimeve. i	Paraqitja grafike e nformacionit	Punë me gjithë klasën
<b>Përforcimi</b> (konsolidimi të nxënësit)	Rishikim në dyshe	Ndërtimi i shprehive P ndërtimore	unë në grupe

### Zhvillimi i mësimit:

- Kontrollon detyrat e shtëpisë
- Mbledh disa fletore për ti vlerësuar ato.

### PARASHIKIMI:

Shkruaj në tabelë një bashkësi numrash.




Drejtoj pyetjen nxënësve: Sa llojë nr. ndodhen në këtë bashkësi ?

Dëgjoj përgjigjen e nxënësve :

- nr. natyror 2, 13
- nr.thyesor (thyesa dhjetore) 4/100, 2/5, 52/100, 4/7., 38/100
- nr. dhjetor 0.68, 0.08

Nxënës të dashur deri tani ne kemi mësuar t'i ndajmë thyesat në:



Bianka LATIFI

Shkolla 9-vjeçare Shushice/Elbasan

Nx. Më shkruani dy thyesa dhjetore me emërues 100

psh. 3/100, 8/100

Thyesa të tilla i shkruajmë:

1) me fjalë “tre të njëqindtat”

2) me nr.me presje **3/100 = 0.03 Rregulla:**

numërojmë nga e djathta në të majtë aq shifra sa zero ka emëruesi

### NDËRTIMI I NJOHURIVE :

Sot ne do të njohim një mënyrë të re të shkruarit e këtyre thyesave dhjetore, me % (përqindje)

- Kush i thotë mësueses se ç'kuptojmë me fjalën % ?

- A e keni dëgjuar më parë ?


Lihen nx. të shprehin mendimin e tyre .-----

- Kush i thotë mësueses tre thyesa dhjetore me emërues 100

Psh : 3/100 = 3%

39/100 = 39%

52/100 = 52%




100 % është i gjithë rrethi

**ETAPA 1: Kthimi i një numri dhjetor në thyesë dhjetore dhe në % dhe kthimi i një % në thyesë dhjetore dhe në nr. dhjetor.**

$$0,35=35/100=35\%$$

$$\text{dhe } 22\%=22/100=0,22$$



**ETAPA 2: Kthimi i një nr. natyror në një thyesë dhjetore dhe në përqindje.**

Marrim nr. 2 dhe 13 që ndodhen në bashkësinë A

$$2=20/10=200/100=200\%$$

$$13=130/10=1300/100=1300\%$$

**ETAPA 3: Kthimi i thyesës në % (thyesë e ndryshme)**

**Rregull:Thyesën e kthejmë në nr. dhjetorë me dy shifra pas presjes duke kryer pjesëtimin e numëruesit me emëruesin.**

**M. 1(mënyra parë)**

$$2 : 7 = 0.28$$

- 0\_

20

$$- 14 \quad 2/7 = 0,28 = 28/100 = 28\%$$

-----

60

- 56

-----

4

**M.2 (mënyra dytë)**

$$2/5 = 2*20/5*20=40/100=40\%$$

3/25=3\*4/25\*4=12/100=12% pra shumëzojmë si emëruesin dhe numëruesin me të njëjtin numër.

**Shembull 1:** Gjeni 30% të numrit 20.

$$30\% \text{ e } 20 \quad \text{=====} \quad 30\%=30/100$$

$$30/100*20= 30*20/100= 600/100= 6$$

**Shembulli 2:** Gjeni numrin kur 25% e tij është nr. 50.  
 $25\% = 25/100$   
 $25/100 * T = 50$   
 $T = 50 * 100/25$   
 $T = 5000 / 25$   
 $T = 200$


• **Grupnivele i katërt:**  
 Shkruaj thyesat në %  $5/10$   $5/10 = 5 * 10/10 * 10 = 50/100 = 50\%$   
 $2/3$   $2/3 = 0,66 = 66/100 = 66\%$

**Minitest**

A) kthe thyesën dhjetore në %  $2 / 100 =$   
 B) kthe thyesën dhjetore në %  $4 / 100$

- **PËRFORCIMI (rishikimi në dyshe)**

*Nx. Çfarë mësuam sot.*



Ndajë klasën në grupe dhe ngr 4 nx ne dërrase për zgjidhjen e ushtrimeve :

- **Grupnivele i parë:**  
Shkruaj thyesat si %  $8 / 100$   $22 / 100$  (= 8 % dhe = 22%)
- **Grupnivele i dytë:**  
Shkruaj % në thyesë dhjetore  $56\%$   $12\%$  (=  $56/100$  , =  $12/100$ )
- **Grupnivele i tretë:**  
Shkruaj % si thyes dhjetore dhe si nr dhjetor  $20\%$   $40\%$   
 $(20\% = 20/100 = 0.20)$   
 $(40\% = 40/100 = 0.40)$

**VLERËSIMET:** vlerësoj nx për saktësinë e përgjigjeve dhe për argumentimin e tyre të %  
 Për përkushtimin në grupnivele në gjetjen e % së një numri  
**DETYRAT E SHTËPISË:** në grupnivele  
 G,1 Kthe thyesat në %;  $34/100$ ,  $5/100$ ,  $30/100$   
 G.2 Ushtrimi 3 fq 47  
 G 3 Gjeni 15% e nr.60 dhe ushtrimi 1 fq 47  
 G 4 Të gjendet nr. kur 20% e tij është 6.  
 dhe ushtrimi 2 fq 47  
**REFLEKSIONET;** VI-b 100 %



# Tema: Zbutja dhe eliminimi i diskriminimit rrit shkallën e qytetarisë

Nëpërmjet kësaj veprimtarie mësuesit (nxënësit) do të njihen me dokumentet themelore të të Drejtave të Njeriut dhe do të aftësohen për të gjetur rrugë, forma e mjete për t'u organizuar në mënyrë të pavarur, për të parandaluar dhe eliminuar shkeljen e tyre. Të jenë të aftë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe të jenë aktivë për të luftuar kundër çdo lloj diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, kombësisë etj. Për të qenë efektiv në këtë luftë, të dinë të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë, duke filluar nga format e thjeshta të organizimit e deri te mediat dhe institucionet joqeveritare në mbrojtje të të drejtave të njeriut. E rëndësishme është të formojmë qytetarë aktivë për të luftuar kundër çdo lloj padrejtësie në mënyrë të pavarur sistematike e me forma demokratike.

### Objektivat

Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të shpjegojë rëndësinë e të qenit aktiv në marrjen e vendimeve për zgjidhjen e çdo lloj problemi në fushën e të Drejtave të Njeriut.
  - Të tregojnë raste të shfaqjes së diskriminimit dhe ç'është bërë për zbutjen dhe eliminimin e tyre.
  - Të rreshtojë disa nga cilësitë e një qytetari aktiv në mbrojtje të të drejtave të njeriut.
  - Të tregojë rëndësinë e përdorimit të medias, si pushtet i katërt e shumë i fuqishëm, në mbrojtje të të drejtave e lirive themelore të njeriut.
  - Të dallojë të drejtat e mohuara dhe të përcaktojnë rrugët për eliminimin e padrejtësive.
  - Të tregojë se si të realizohen të drejtat e njeriut në mjedisin ku jetojmë.
  - Të argumentojnë rëndësinë e integritimit në shoqëri të atyre që janë mënjanuar (përjashtuar, diskriminuar).
- Materiale: Variant i shkurtuar i DUDNJ, format të bardhë A4, tabakë, letra, lapsa me ngjyra, ngjites.

### Zhvillimi i veprimtarisë

#### Hapi i parë

Mësuesi kërkon nga nxënësit të japin përkufizimin e tyre për diskriminimin, përjashtimin, mënjanimin, integrimin. Ndërkohë që nga "Fjalori i Shqipërisë së Sotme", Tiranë 1984, ai ka nxjerrë kuptimin gjuhësor si më poshtë:

- Diskriminim: veprimi dhe gjendja sipas diskriminimit, diskriminohem.
- 1) Diskriminim: E dalloj dikë nga të tjerët dhe e trajtoj keq, duke mos e quajtur të barabartë me ta dhe duke ia kufizuar e mohuar fare të drejtat që i takojnë. Diskriminim njerëzit me ngjyrë. (pakicat kombëtare)
  - 2) Diskriminim pozitiv: Diskriminimi pozitiv njihet si diskriminimi i kundërt ose pozitiv. Është mjet për të zhbërë diskriminimet e së kaluarës dhe për të parandaluar diskriminimet e së ardhmes.
  - 3) Diskriminim: Diskriminimi është akti i të bërit ose i njohjes së dallimeve ndërmjet njerëzve. Me diskriminim zakonisht në kuptojmë akte të dyshimit apo të urrejtjes ndaj grupeve të veçanta të njerëzve, të tilla si gratë apo grupet e pakicave racore ose fetare. (Marrë nga "Fjalorth terminologjie i të Drejtave të Njeriut" Projekti i UNESCO-s "Edukimi Ndërkulturor i të Drejtave të Njeriut në Shqipëri".)

- Integrim: Veprimi sipas Integrojt, Integrohem.

1) Integrojt: Lidh pjesët, ose anët e diçkaje në një të tërë,

Punoi: Vladimir SHAKAJ  
Pedagog - Universiteti i Elbasanit

përfshij gjithçka në një të tërë si pjesë përbërëse e të pandarë të saj; bashkoj a shkrij në një njësi të vetme.

2) Integrohem: Lidhet ngushtë me të tërën, përfshihet në një të tërë, si pjesë përbërëse e pandarë e saj; bashkohet a shkrihet në një njësi të vetme gjatë zhvillimit

### Hapi i dytë

Mësuesi e ndan klasën në katër grupe. Ndarja mund të bëhet rastësore, sipas dëshirave të pjesëmarrësve, duke tërhequr një numër etj. dhe i udhëzon grupet të caktojnë funksionet e anëtarëve. Pastaj ai shpërndan në çdo grup bazën materiale: tabak letra, format A4, lapsa me ngjyra, kopje të shkurtuara të DUDNJ etj. dhe i jep secilit grup situatën për të cilën do të diskutojnë.

### Fletët e punës së grupeve - situatat

#### Situata I

Ermira, nxënësja simpatike, inteligjente, shembullore, e urtë, e dashur, e sjellshme që e kishin zili të gjithë, papritur u ndodh përpara një gjëme që do t'ia ndryshonte përfundimisht e do t'ia bënte jetën skëterrë.

Një mëngjes të bukur, rrugës për në shkollë i ndalon te këmbët një makinë me targa të huaja. Dy djem të fuqishëm e mbërthejnë dhe e fusin në makinë pa i lënë kohë të kërkonte ndihmë. E çuan në një shtëpi të pabanuar në breg të detit. E përdhunuan dhe rrahën barbarisht. E keqtrajtuan në atë formë sa vetëm shpirti i saj e dinte. Më pas e dërguan në Itali për të bërë punën e prostitutës. E vetme, e pambrojtur, e rrahur, e përdhunuar, e torturuar, priste ditën të shkëputej nga ky terr i pafund. Kjo ditë nuk vonoi. Nuk kaloi as dy muaj, ajo mundi të largohej e të kthehej në shtëpi. Por kalvari i vuajtjeve dukej se nuk do të mbaronte për të. Familja nuk e pranoi në shtëpi nga turpi. (Ç'turp kishte bërë ajo!?) E mori gjyshja dhe gjyshja. Banorët e lagjes e disa prej shokëve dhe shoqeve, m kur ndesheshin rrugës, i bënin bisht, nuk i flisnin. Por pati edhe nga ata që e takuan dhe e pyetën se ç'ndihmë deshte prej tyre. Ajo u tregoi atyre se donte të vazhdonte shkollën, por drejtori heziton se disa prej prindërve tuaj i kanë thënë që të mos më regjistrojë në shkollë se mund të prish vajzat e tjera. –Nuk e di si të veprojmë – thotë ajo – dhe si ju mund të më ndihmoni. Nuk e di. –Do të ndihmojmë – i thanë shokët. Si mund ta realizojnë këtë?



**Pyetje dhe detyra**

- Cilat të drejta i janë mohuar Ermirës?
- Ku bie në sy diskriminimi?
- Si do të zgjidhet problemi i saj? (Si do të realizohet integrimi)
- Tregoni një rast analog. (Punë grupi)

**Situata II**

Dy studentë, Anila dhe Adi, dashuroheshin me njëri – tjetrin dhe ishin mjaft të lumtur me dashurinë e tyre. Të dy ishin inteligjentë, simpatikë, të komunikueshëm dhe mjaft të këndshëm për shoqërinë. Ata dashuroheshin pa u ruajtur nga syri i botës, siç i thonë. E natyrisht, kjo gjë do t'i çonte drejt fejesës. Anila ishte dakord që ta shpallnin fejesën, ndërsa Adi hezitonte. Ajo kërkonte t'i takonte prindërit, vëllezërit e motrat e Adit dhe ai të sajte, por ai stepej dhe bëhej u heshtur. Anila u tregon prindërve të saj për dashurinë me shokun e fakultetit dhe që donte të fejohej. Prindërit nuk u çuditën se diç kishin dëgjuar për këtë lidhje. –Mirë, mirë, - tha babai – ngadalë se nuk të ngut njeri. Mendojmë ne për ty, je e vogël akoma. Na thuaj emrin e djalit dhe adresën. Të pyesim njëherë. Apo jo? – Po – ia kthen mamaja – është normale.

Babai i Anilës zbuloi se Adi, i dashuri i vajzës së tij, na ishte me origjinë evgjit. Vajti në shtëpi pa mend në kokë. E mbylli vajzën brenda dhe filloi të ulërinte sikur t'i kishin ngulur një thikë pas shpine. – Vajza ta lërë shkollën. I dashuri i saj është evgjit. Evgjitet nuk kanë punë në shtëpinë time, etj. etj. - ulërinte e sokëllinte i jati i Anilës.

- Unë e dua, baba. Edhe ai është njeri si gjithë të tjerët. Unë fundja jam e lumtur me të, – foli e vendosur Anila.

Po kujt t'i dilte përpara? Si të bënte? Ta linte Adin? T'i nënshtrohej prindërve? Edhe disa nga shokët i kishin thënë të shkëputej nga Adi dhe raca e tij.

**Pyetje dhe detyra**

- Cilat të drejta i mohohen Anilës dhe Adit?
- Ku duket diskriminimi?
- Jepni mendimin tuaj për zgjidhjen e kësaj situatë. A mendoni se ka zgjidhje?
- Jepni një rast analog. (Punë grupi)

**Situata III**

Në një nga universitetet më në zë të Amerikës kishte lindur një problem që kishte bërë zhurmë dhe kishte hapur diskutime të shumta në qarqet intelektuale dhe aktivistët e të Drejtave të Njeriut. Pastruesit e këtij universiteti kishin rënë në belë me përgjegjësit e tyre. Ditë pushimi nuk i jepte. Orarin e bënte sipas qejfit. Pajisjet ua jepte gjysmake. Me një fjalë, shinte me to sipas qejfit. Mirë këto po i ngacmonte edhe seksualisht gjatë orarit të punës. Pastrueset bisedonin kokulura me njëra – tjetrën. Këtë problem e kishin dëgjuar rastësisht edhe nja dy pedagogë, por nuk i dhanë rëndësi. “Hë, mo, se pastruese janë.” Mendonin ata. Njëra prej pastruesve, e mërziur sa më s'ka, u thotë shoqeve, “Nuk vazhdohet më kështu” “Po ç'të bëjmë, nuk na e vë veshin njeri. Ai ka mik rektorin e universitetit. Ne pastruese jemi,- thanë ato. Si të bëjmë? Kjo është e padurueshme. Media ishte tepër e ndjeshme rreth problemeve që ndodhnin në universitet.

**Pyetje dhe detyra**

- Cilat të drejta u janë mohuar pastrueseve?
- Ku duket diskriminimi?
- Si do normalizohej ky problem?
- Jepni një rast analog. (Punë grupi)

**Situata IV**

Edlira ka filluar vitin e parë në shkollën e mesme të përgjith-

shme. Dëshira e saj ishte shkolla e gjuhëve të huaja, por prindërit nuk e lanë, se e dinin ata të mirën e vajzës së tyre të vetme, të bukur dhe inteligjente. Për ta ajo ishte Edlira e vogël, e pazonja për të marrë vendime për jetën. Edhe veshjet, ushqimin, shoqërimin me shokë dhe shoqe ia zgjidhnin prindërit. Edlirës nuk i vinte mirë, por nuk ia prishte dot.

-Mos u shoqëro me Valmirën,- i thotë mamaja “ata janë të varfër e të pashkollë. Nuk janë niveli jonë.” Valmira dhe prindërit e saj ishin njerëz të mrekullueshëm, punëtorë, pa fjalë, të dashur. Ku qëndronte dallimi këtu? Edlira nuk i kuptonte, por mirë nuk i vinte që e ndalonin të shoqërohej me të. Ajo donte të luante, të argëtohej e të gëzonte me moshatarët e saj, por prindërit nuk e lejonin.

-Do të bëjmë vizitë te Vasili. Familje e ngritur. Djalin e ka student. Ke ç'mëson prej tyre,- thoshte babi.

Këto vizita ishin një tmerr i vërtetë. Njëri fryhej më shumë se tjetri, ngrinin veten e ulnin të tjerët, thashetheme pa-pushim. Ky ambient po bëhej i padurueshëm për Edlirën, po e mbyste. Por fjalën e saj nuk e dëgjonte njeri.

-Ti je e vogël e do bësh si të themi ne. Të mirën tënde e dimë ne, prindërit e tu.

Si të bëj? Kështu nuk shtyhet më.

**Pyetje dhe detyra**

- Cilat të drejta i mohohen Edlirës?
- Ku duket diskriminimi?
- Ç'mendoni ju për të ndryshuar gjendjen?
- Jepni një rast analog (Punë grupi)

**Hapi i tretë**

Pasi kanë përfunduar grupet paraqesin punën e tyre përpara të gjithë klasës, e cila ka të drejtë të bëjë pyetje ose të shprehë komentet dhe përfundimet e secilit grup.

Hapi i katërt

Reflektim. Në këtë fazë mësuesi fton të gjithë nxënësit të shprehin mendimin ose ndjenjat e tyre për veprimtarinë ose përfundimet e saj (çështjet, opinionet etj.). Për të ndihmuar procesin e reflektimit mësuesi mund të bëjë pyetjet e mëposhtme:

- Si u ndjetë gjatë veprimtarisë?
- Ju befaso i ndonjë gjë?
- A përfituat prej saj?
- Si mund të zhvillohej ndryshe?
- A është i theksuar diskriminimi dhe ksenofobia në vendin tonë?
- A dini vende që e kanë të theksuar atë?
- Si mund të luftohet kundër diskriminimit?
- Cilët janë disa nga faktorët që e ushqejnë dhe e mbajnë gjallë atë etj.



# Natyra e kualifikimeve kyç: Një analizë e kohës

*Në këtë trajtesë, ju të nderuar lexues e kolegë, do të ballafaqoheni me konceptin e kualifikimeve kyç aq të rëndësishme sot në botë, mendime dhe ide profesioniste të shumë autorëve më në zë në Europë.*

## Koncepti i kualifikimeve kyç

1. “Koncepti i kualifikimeve kyç” - përgjithësisht do të thotë aftësi për të transmetuar veprime konkrete në situatat e reja dhe të gjesht zgjidhje në mënyrë të pavarur.

2. “Kualifikimet kyç, përgatitje e gjithanshme”

Këto përcaktime janë marrë marr nga program i seminarit të organizuar nga Organizata ndërkombëtare e Arsimit Profesional CIEA në vitin 1998 në Grangeneuve, Zvicër në të cilën kam marrë pjesë vetë me përfaqësues nga 41 vende nga e gjithë bota.

## Pyetjet që dalin nga citimi i parë:

Çfarë veprimesh? Çfarë situatash?

“Të reja” do të thotë “relativisht të reja” apo “absolutisht të reja”?

Pse në mënyrë të pavarur?

## Pyetjet që shfaqen nga citimi i dytë:

Çfarë konceptesh të reja mund të zëvendësohen për “kualifikimet kyç” pa e bërë slogan të papërshtatshëm konceptin tonë për trajningun?

Janë kualifikimet kyç produkte, vegla apo procese?

Është tunduese që të pranojmë se njëri nga citimet mund të përcaktojë lehtësisht një koncept aq qartë sa “kualifikimet kyç”. Ky pikërisht është imazhi i gjallë i zotërimit të një çelësi, në formën e kualifikimeve, që do të hapin një derë ose portë për njerëzit në botën e punës, që ngre lart shpresat e tyre. Ndoshta është fakt që ky koncept mund të nënkuptojë diçka për çdo njeri, i cili ka ndihmuar që të bëhet kaq popullorë. Çdo njeri i interesuar mund të interpretojë këtë koncept sipas mënyrës së tij. Fakti që ky unitet dhe aspekt i lirisë së problemit përshfaqet në copëza ekzaminimi më të imët rrëfëhet në përcaktimet e mëposhtme:

## A: Përcaktimi i kufijve të konceptit kualifikime kyç (Një koleksion i shkurtër paksa arbitrar dhe i rastësishëm)

1. Si e kupton **Mertsen** këtë

Kur Mertsen, një politikan i tregut të punës, karakterizon tiparet e kualifikimeve kyç, ai nuk është i interesuar për përkrahjen e individit si një i tërë. Interesi kryesor i tij është që ky individ duhet të jetë nëpunës i ardhshëm, i lëvizshëm dhe i aftë për të zënë punë në një shumëllojshmëri sa më të mundshme aktivitete. Ai e lidh aftësinë për të zënë punë në pjesën më të madhe me zotërimin e aftësive intelektuale dhe konjuktive. (Laur-Emest, 1990) Këtu Mertsen diferencën katër tipet e kualifikimeve kyç:

**Kualifikimet bazë** d.m.th. kualifikimet e një shkalle më të lartë, me transferim vertikal në sferat e specializuara të njohurive dhe aplikimit. Këto kualifikime shtrihen kryesisht në fushën e trajnimit të mendimit. Për shembull: të menduarit logjik. Shembulli i të mësuarit të lëndës: logjikë formale.

**Kualifikimet horizontale** sigurojnë përdorimin më të mundshëm të horizonteve informative njerëzore (informim

Nga **Irfan RAMA** - Shkolla e Mesme Bujqësore Kamëz

rreth informimit). Shëmbull: të mësuarit e lëndës: anije bibliotekare.

**Elementët e gjerë** janë ato elementë të veçantë të njohurisë që përduken aq të rëndësishëm - si të lexuarit dhe të shkruarit - sa që ato tashmë janë përfshirë në nevojat e përgjithshme të arsimit në ditët tona. Si shëmbull, lënda: teknologjia e matjes.

**Faktorët e mbarë** janë ato përbërës të arsimit që janë zëvendësuar me ndryshimet vazhdueshme që kanë lindur midis breznive. Si shëmbull marrim lëndën: teknikat e programimit të kompjuterit. (Reetz, 1990)

2. Si kuptohet nga **Bunks** dhe më pas nga **Dubs**

Bunks i nis kualifikimet kyç nga shpjegimi antropologjikopedagogjike dhe ai formulon tezën se kualifikimet kyç në themel nuk kanë asgjë por “rizbulimin e një kualifikimi të integruar arsimor profesional, i cili kishte humbur gjatë të mësuarit të specializuar, organizuar nga shkollat e kolegjet dhe me ndarjen e specifikuar të detyrave organizuar në punën profesionale”. (Bunks, 1990)

Dubs ndjek tezën e Bunks. Ai gjithashtu i kupton kualifikimet kyç si një rizbulim të një kualifikimi të integruar arsimor dhe profesional (Dubs, 1990)

3. Si kuptohet nga **Meifort**

Meifort (1991) e kupton konceptin e kualifikimit kyç si kualifikime “që i japin mundësi trajnuesve dhe puntorëve që jo vetëm të jenë në lartësinë e duhur me kërkesat e punës profesionale por gjithashtu - dhe më e rëndësishmja - i ndihmon ato të formojnë dhe ndryshojnë përmbajtjen dhe format e punës”. Përfundimisht, ajo i përshkruan kualifikimet kyç si “kualifikime të njerëzve të orientuar”.

4. Si kuptohet nga **Becker**

Becker vendos përpara një mënyrë tjetër kuptimi të kategorisë së kualifikimeve kyç. Ai hedh poshtë përshfaqjen si qëllim të trajnimit profesional dhe zëvendëson këtë me synimin e aftësive për të nxënë. Në opinionin e tij, koncepti kualifikime kyç duhet të jetë kuptuar si një plan “që përcakton për trajnim profesional ato përmbajtje dhe kushte të trajnimeve që nuk janë ekonomikisht të lidhura me rezultatin, por janë gjithashtu – dhe mbi të gjitha – subjektivisht të rëndësishme. (Becker 1991). Kualifikimet kyç duhet të jenë përcaktuar nga pikëpamje se ato bëjnë pjesë në profesionin e veçantë. Trajnimi duhet të ketë studentin në qendër.

5. Si kuptohet nga **Brater, Buchele, Fuche dhe Herz**

Brater, Buchele, Fuche dhe Herz e kuptojnë konceptin e kualifikimit kyç tërësisht si kualifikime të bazuara tek profesionaliteti, të tilla si pavarësia, aftësia për improvizim, fleksibiliteti, kompetenca sociale, aftësia për të kooperuar dhe komunikuar. (Brater, Buchele, Fuche, Herz, 1998)

## B: Komente mbi koleksionin e listuar

1. Përcaktimi i kufijve ose përcaktimet e konceptit janë shumë më tepër abstrakte se sa termat “çelës, mbyll, derë” ndaj duhet këshilluar me shoqatën.

2. Të paktën tre përgjasime shumë të ndryshme mund të vëzhgohen:

- Fokusi mbi tregun e punës (shëmbulli i Mertens), për t'i dhënë mundësi punëmarrësve për të qenë fleksibël.

- Fokus mbi teorinë e arsimit (shembulli Bunk ose i Dubs) si për shembull rizbulimi i një kualifikimi të integruar arsimor dhe profesional ose (psh. Becker) si aftësi për të mësuar dhe formuar.

- Fokusi mbi një çlirim të teorisë së personalitetit të përcaktuar (shembulli Meifort), si një kualifikim me njerëzit në qendër ose si faktorët e personalitetit.

3. Asnjëri nga autorët e cituar nuk përmendin në mënyrë të qartë për një teori personalitetit ose të një imazhi human të qëndrueshëm. Ky sfond mbetet i patregueshëm.

### C: Teoria e arsimit afron me G.P.Bunk (Dorig, 1994)

Siç kemi përmendur tashmë lart, Bunk i konsideron kualifikimet kyç si një rizbulim i një kualifikimi të integruar arsimor profesional. Për atë, ato nuk janë asgjë më tepër ose më pak se sa një qëndrim i mendjes: një pikpamje e cila dëshiron që proceset arsimore të bëhen më tepër të integruara dhe rishtaz më të orientuara si proces. Ai e bazon përngjasimin e tij mbi një sfond të teorisë së arsimit, të cilin ai e vendos në terma konkrete si vijon:

#### Kualifikimet kyç

1. Materiale, njohuria dhe shkathtësitë. (Faktori i përgjithshëm)

- Njohuritë dhe shkathtësitë me efekte të mëdha e të gjera (Teknikat e matjes, prezantimi dhe portretizimi me gojë e me shkrim, teknikat e praktikave të sigurimit në punë).

- Njohuritë dhe shkathtësitë me qëndrueshmëri të madhe (Teknikat e kultivimit, gjuhët e huaja, njohuritë elementare të ekonomisë e teknologjisë)

2. Aftësitë formale. Veprimi i pavarur. (Faktori i pavarur) Aftësi reagimi dhe transferimi, p.sh të jesh i aftë për të reaguar me ndryshimin e situatave të punës në një mënyrë konkrete dhe profesionale, duke përdorur procese konkrete, duke qenë i aftë të skicojë përfundimet e drejta nga rezultatet. Rikonicioni i pavarur, planifikimi, zbatimi, vlerësimi.

3. Sjellja e personelit. Format e sjelljes. (Faktori human)

- **Format e sjelljes individuale** (Iniciativa, qëndrueshmëria, qëndresa, fleksibiliteti, përshtatshmëria, gatishmëria për punën, motivimi)

- **Format e sjelljes shoqërore** (Aftësitë për kooperim, aftësia për të kontaktuar, aftësia për të komunikuar, rregullsia, toleranca, shpirti i grupit, ndihma ndaj shoku shokut, gatishmëria për të pranuar konsensusin)

- **Format e sjelljes në punë** (Virtytet në punë, duke përfshirë precizionin, vetëdija në momente deçizive, vetëdija për cilësinë, ndershmëria, rehabilitimi, gatishmëria për të vepruar, gatishmëria për të pranuar teknologjinë)

- **Format e sjelljes së përgjegjshme** (Aftësia dhe gatishmëria për të organizuar vetë punën në një hapësirë me një mënyrë të konsideruar, aftësia dhe gatishmëria për të marrë vendime personale, aftësia dhe gatishmëria për të marrë përgjegjësi, aftësia dhe gatishmëria për të ndjekur diçka me koshiençë dhe për të vepruar në pajtim me principet etike)

### D: Lidhja e kualifikimeve kyç të Reetz me teorinë e personalitetit (Reetz, 1990)

Reetz zhvendosi theksin e kualifikimit nga konkretja, nga kërkesat profesionale të specializuara, duke e lëvizur këtë në qendër të personalitetit të individit. "Krahasuar me detyrimet normative të mëparshme të trajnimit profesional – 'njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë' – kualifikimet kyç si rrjedhojë kanë për qëllim një formë më të lartë të kompetencës profesionale". (Reetz, 1990). Sipas Reetz,

kualifikimet kyç janë si rezultat i shprehjes së një aftësie të pjekur individuale për të vepruar në marrëdhënien e tij me mjedisin.

Sërish sipas Reetz, një koncept i kualifikimeve kyç sikurse ndërtesa e personalitetit është në përputhje me strukturën pedagogjike të të nxënës dhe të punës. Me qëllim që të zhvillohet më tej koncepti i kualifikimeve kyç që është e mjaftueshme tok me teorinë dhe praktikën, duhet të merren parasysh kërkesat e integruara drejt ndërtesës së personalitetit. Në këtë kontekst Reetz rikthehet në teorinë e personalitetit të Roth. Për atë kjo paraqet një rrugë të realizueshme sepse kjo vendosë aftësinë njerëzore të veprimit në qendër. Kjo aftësi humane që vepron, shpreh në të vërtetë tre dimensione:

*Dimensioni i sjelljes së shkathtësisë së kushtëzuar. (Kompetenca e kushtëzuar dhe pjekuria intelektuale)*

*Sjellja e shkathtësisë sociale. (Kompetenca sociale dhe pjekuria sociale)*

*Sjellja, shkathtësi me vlerë. (Vetëkompetenca dhe pjekuria morale)*

### E: Disa rreshta për mendimin.

1. Mund të jetë e dobishme të dallojmë midis tyre kualifikimet e sjelljes, kualifikimet e profesionit dhe kualifikimet e inteligjencës. Në të tria rastet, dhënia e imazhit të një çelësi për kualifikimin mund të na çojë në konfuzion, sepse imazhi i një çelësi kuptohet më shumë si një çelës mjeshtri se sa çelës që do të hapë një derë.

2. Kjo ide, që duhet të mundësojë izolimin e kualifikimeve kyç të mjeshtrit, ka bindur shpejt këta të cilët skicuan planet e trajnimit. Verifikimi empirik i këtyre apriorizmave është i vështirë dhe rrallë bindës.

3. A janë kualifikimet kyç për edukatorët si shfaqja e jashtme e një personi për sociologët (Bourdieu), ashtu si tiparet e personalitetit janë për psikologët?

#### Literatura:

Stoll François, Zurich, Switzerland: "The nature of Key qualifications: An up-to-date survey" (Leksion) 21-st International Course on Vocational Education and Teaching in Agriculture 1998 Grangeneuve, Zvicër.

Revista "The Economist", Mars 2009; Liljana Elmazi, Drejtimi i Marketingut UT, 2009; Ervin Demo, Petrit Dollani, Komunikimi në Biznes, UT, 2007; Cikël leksionesh mbi "Cilësinë dhe sigurimin e cilësisë", Londër, Mars, 2010



# Dhjetë këshilla për mësuesit

Gjithkush që është marrë me arsimin, është e pamundur të mos ketë hasur momente të vështira, për të mos thënë sfiduese me ndonjë nga nxënësit e tij. Sfidat mund të ketë konsistuar në një kërcënim të drejtpërdrejtë, përpjekje për të t'i kthyer të gjithë nxënësit e klasës kundër, etj. Ngandongëherë, duket sikur situata do të shpërthejë në klasë, por çfarë bëjmë ne në këto momente? Njohja e strategjive për t'i kthyer këto situata nga të rrezikshme në shanse për të mësuar, kërkon nga ne që të dimë t'u japim zgjidhje shumë temave të rëndësishme si: besimi fetar, politika, racat, shtresëzimet e shoqërisë, çështjet gjinore, etj.

Këto momente mund të jenë shumë shkurajuese, madje dhe poshtëruese nëse ju nuk keni ndonjë plan apo strategji se si t'i menaxhoni këto nxënës dhe situata të vështira. Momentet e vështira ndodhin kur ndjenjat e një nxënësi që mund të jenë shpesh konfliktuale, mund të arrijnë në atë pikë sa të mund të prishin procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Këto momente mund të ndodhin gjatë diskutimeve të çështjeve për të cilat nxënësit mund të jenë shumë të interesuar, ose si rezultat i zhvillimeve të ngjarjeve të ndryshme në klasë.

Për fat të mirë çdonjëri nga ne mund të përdorë teknika për të menaxhuar këto momente të pashmangshme që mund t'i ndodhin kujtdo në klasë. Përdorimi i këtyre teknikave mund t'i hapë dyert temave që më parë as që mendoheshin të diskutoheshin në klasa dhe t'i kthejë ato në burime të të nxënësve për jetën. Përjetimi dhe menaxhimi i këtyre momenteve të tensionuara mund të bëhen një burim përvojash, që na bëjnë edhe ne mësuesve të mësojmë diçka.

Më poshtë po ju paraqes 10 këshilla të lehta për t'u zbatuar, të cilat do t'ju ndihmojnë se si të merreni me këto situata dhe si t'i kapërceni suksesshëm ato, në mënyrë që mësimi të mos priset dhe ju të vazhdoni normal orën e mësimi:

1. Bëni një frymëmarrje të thellë dhe kujtohuni që e gjithë kjo që po ndodh në orën tuaj nuk është personale. Kujtdo mësuesi mund t'i kish ndodhur, por fati e deshi të ishit ju ai që duhet të merrej me këtë situatë. Një frymëmarrje e thellë ju ndihmon të harroni egon tuaj dhe të merreni me situatën të pangarkuar emocionalisht.

2. Duhet ta shihni drejt e në sy nxënësin, ose nxënësen që po ju sfidon. Është mirë që të lëvizni nëse jeni ulur.

3. Përsëriteni edhe një herë atë çka i keni kërkuar më parë këtij nxënësi duke e parë atë në sy dhe duke ruajtur një ton të qetë zëri, por të vendosur. Kjo i jep mundësinë nxënësit të mendojë edhe një herë për atë çka i keni kërkuar.

4. Vendosni rregullin në klasë. Mësojuni nxënësve atë çfarë pritet prej tyre që në fillim, pa prituri që problemet të ndodhin realisht në klasën tuaj, me nxënësit tuaj.

5. Një shaka me nxënësit tuaj ndihmon trurin të relaksohet dhe nxit të mësuarit aktiv dhe me dëshirë. Sa herë të jetë e mundur krijoni situata të tilla në klasë dhe do të shihni që nuk do jetë pa rezultat.

6. Vendosni një sistem menaxhimi të sjelljes së nxënësve, një sistem që nxënësi të kuptojë se cila është sjellja e duhur dhe jo e duhur në ambientet e shkollës dhe jashtë saj. Vlerësoni ato nxënës që gjithnjë dallohen për sjellje korrekte me mënyra të ndryshme, por hapur që nxënësit me sjellje jo korrekte të dinë se çfarë pritet prej tyre. Kjo është mënyra më e mirë për t'i vënë në dukje sjelljen e tyre të keqe pa i sharë dhe ofenduar ata drejtpërdrejtë.

7. Shpjegojini nxënësve se cilat janë pasojat e një sjelljeje të pamundur dhe të nxituar. Fare mirë mund të sillni në klasë edhe shembuj nga jeta juaj shkollore, shembuj që ata ta

**Nga: Mimoza BERISHA (THAÇI)/AVA**

kuptojnë se dhe ju keni qenë dikur si ata dhe i kuptoni, por në të njëjtën kohë i ndihmoni për t'i kapërcyer vështirësitë e moshës.

8. Tregojuni nxënësve se ata kanë mundësinë e zgjedhjes së dy alternativave:

*Të sillen sipas rregullave të caktuara nga shkolla dhe të miratuara prej tyre;*

*Të largohen nga ora e mësimi, që do të thotë marrje masash të mëtejshme për sjelljen jo korrekte të treguar në klasë.*

9. Shmangni diskutimet e tepruara. Shumë nga këta nxënës janë të mësuar me të tilla situata, madje janë pothuaj të njëjtët që paraqesin probleme të tilla. Janë mësuar me këshilla të zgjatura se si të sillen e si të mos sillen nga prindërit në shtëpi. Prandaj, zgjatja e debatit nuk është se do të zgjidhte gjë në një situatë të tillë. Mos ua ushqeni bisedën. I qëndroni qetësisht dhe me vendosmëri kërkesës suaj. Pyeteni nëse ai e ka kuptuar atë çka i keni kërkuar dhe përsëritjani qetë dhe vendosmërisht nëse ai tallet dhe thotë se nuk e ka kuptuar atë çka i kërkohet të bëjë.

10. Ndongëherë është e rëndësishme që të flasësh me nxënësit jashtë klasës, veçanërisht me këta nxënës që krijojnë gjithnjë probleme. A këta nxënës të mësojnë diçka të rëndësishme nga ky rast; të mësojnë diçka për veten e tyre, për të tjerët, për pozicione të ndryshme që njerëz të ndryshëm mund të kenë rreth atij problemi për të cilën ata janë kaq të preokupuar aq sa të krijojnë shqetësim për klasën. Me ta duhet folur rreth asaj teme për të cilën u krijua edhe ajo situatë e vështirë në klasë. Ata duhen mësuar se si t'i shprehin drejtë mendimet dhe ndjenjat e tyre në mënyrë që të dëgjohen nga të tjerët dhe të merren në konsideratë nga të tjerët. Ata duhet të pranojnë se jo të gjithë duhet të kenë të njëjtin qëndrim rreth një problemi të caktuar dhe duhet të mësohen ta pranojnë edhe mendimin ndryshe si një gjë krejt normale. Këto bashkëbisedime me nxënësit mund t'i shpëtojnë ata me tërë kuptimin e fjalës dhe të bëjnë që ata të vazhdojnë të vijnë në klasë me një mendësi më të qartë dhe më të hapur.



## PSIKO-DËSHMI 3

*Imitimi i më të mëdhenjve, si përshtatje apo si sfidë*

Nga folklori ynë, ninullat e famshme apo siç quhen ndryshe këngët e djepit, na sjellin panoramën e dëshirës njerëzore që fëmija të bëhet më i miri i të mirëve. Ndërshembuj të gjallë, referimet

shkojnë më shumë drejt figurave trimërore, drejt bukurive të përsosura dhe drejt përjetësisë. Mirëkuptimi njerëzor nuk përshkallëzon krahasimin, por kalon direkt te shkalla sipërore.

Nga ana tjetër, të gjithë e kemi provuar në fëmijërinë e hershme, apo të vonë shprehjen: Ky nuk është si ai, apo ky i ngjan shumë atij. Në varësi të kontekstit, për të cilin përdoret njëra apo tjetra, ne ndjehemi krenarë apo të nënshtruar. Qenia e ndërvarur nga ngjashmëria dhe përshtatja përbën në një pjesë të mirë të rasteve një mjedis që sjell mjaft probleme dhe shqetësime, sidomos për fëmijët.

Fëmijëve u pëlqen t'u ngjajnë modeleve të mira ku futen: prindërit, gjyshërit, motrat dhe vëllezërit më të rritur, kushërinjtë, etj. Ata përpiqen ta ndjekin këtë model që u vihet në dukje. Por e gjitha kjo nuk rezulton të jetë gjithmonë e drejtë. Pasi personaliteti individual jo vetëm që vihet në provë, por ka nevojë edhe të shfaqë vetveten, pse jo edhe të ndryshojë në disa raste, apo me vitet dhe rritjen.

Vënia në provë ka të bëjë me faktin se si ndikon kjo te fëmija. Në fakt, ka edhe ndikime negative edhe pozitive. Të viresh në provë do të thotë edhe se si ti, mund të reagosh ndaj një modeli të duhur: të mërzhitesh, të trishtohesh, të krenohesh, të sfidosh, etj. E gjitha kjo sjell zbulimin e vetvetes duke e bërë personalizimin aktiv. Në këtë moment sheh edhe çfarë pëson zhvillimi i fëmijës. Jo në të gjitha rastet ai është i njëtrajtshëm dhe unik. P.sh një fëmijë u ndje mjaft keq kur mësuesi me mjaft seriozitet i tha: Sa keq që ti nuk je si motra jote! Ajo shkëlqente në letërsi... Fëmija i çuditur mendonte se çfarë faji kishte bërë dhe pse nuk po lëvdohej pasi ai ishte në të vërtetë shumë më mirë në sporte.

E krahasuar me këtë shpjegim na vjen rasti kur personaliteti ka ngjashmëri të dukshme. Nisur nga parimi etik i së mirës, radha këtë rast i vjen fëmijës në ndihmë të shprehë krenarinë e vet. Në pjesën më të madhe të rasteve, ai lëvdon ngjashmërinë duke konstatuar veti

Adriatike LAMI - AVA

të kësaj edhe te vetja. Tiparet më të dallueshme në këtë rast lidhen me zgjuarsinë, vullnetin, bukurinë, aftësinë për të folur dhe për t'u shprehur, talentin në gjëra të veçanta etj.

Mjaft e dëmshme kjo rezulton kur fëmijës ia përdor në kontribute negative. Në rast se ai kryen një sjellje të papëlqyeshme dhe ti i thua: sa keq që i ngjan të atit në këtë gjë, atëherë ne kemi dëmtuar atë pjesë që, realisht me forma dhe mënyrë të tjera, mund ta rregullonim.

Cila është në të vërtetë e drejtë?

E sigurt që më e mira e të mirave është dukja personale. Ne duhet t'u themi fëmijëve tanë: Ju jeni kështu... dhe kjo na pëlqen te ju...

Nisur nga dy shembujt më lart, një pjesë e fëmijëve fillojnë të shmangen një pjesë të imitojnë, një pjesë të tejkalojnë dhe të sfidojnë. Shumë pak nga kjo kategori përpiqen të jenë vetvetja.

Sistemet e hapura të komunikimit sot në shkolla mundësojnë prezantimin e drejtë të natyrës së fëmijëve, duke iu larguar sa më fort imitimit dhe duke krijuar me dëshirë mjedisin për të shfaqur ashtu siç është natyrën e secilit, që përsëri mund të jetë e ngjashme me dikë, por nuk është e detyrueshme dhe për më tepër nuk është imituese të thuhet dhe të vihet në dukje vend e pavend.

Të ndjekësh modelin nuk duhet të kthehet në një gjë të pashmangshme, por të ndjekësh modelin duhet të kthehet në një pjesë edukuese, ku etika kujdesësh të mos dëmtojë ata që e kanë atë brenda vetes. Të vetëkuptuarit, ose përballja e brendshme ka pozitivitet dhe paraqet vlerat e natyrshme të fëmijës dhe lë mundësi për të rregulluar cilësinë e etikës me vitet.



# Niveli i shkollimit të të rinjve dhe nevojat e zhvillimit ekonomike shoqëror të vendit

## *Disa mendime rreth zgjerimit aktual të arsimit universitar në Shqipëri*

*vijon nga numri i ardhshëm*

Nuk mund të mohohet nevoja e zgjerimit të arsimit universitar për fusha të caktuara, si p.sh., për mjekësinë apo mësuesinë, por, ndërkaq, për fusha të tjera, në të cilat kërkesat e tregut të punës nuk janë të mëdha ose janë të papërfillshme, ka superprodhim specialistësh. Në këto rrethana, besoj se neve, aktualisht, nuk na duhet rritja e përqindjes së popullsisë me arsim të lartë sa në vendet e tjera, kryesisht të zhvilluara, gjë që nuk është tregues aq domethënës për nivelin e zhvillimit ekonomik, por një cilësi e lartë e diplomave universitare, aq sa të mund të njihen nga Bashkimi Evropian. Po edhe sikur të argumentohet katërçipërisht se edhe ne duhet të arrijmë në po ato kuota të popullsisë me arsim të lartë, si BE-ja dhe SHBA-të, pse me kaq ngut, pse me ritme kaq të përshpejtuara, duke mos pasur aq nevojë dhe duke e bërë këtë në dëm të cilësisë?

Është e kuptueshme se në kushtet e një përqindjeje të lartë papunësie, përfshirja masive e të rinjve në shkollat e larta është një mjet i volitshëm për uljen e tensioneve shoqërore, por kjo është e përkohshme. Shumë të rinj do të pësojnë zhgënjim të madh nëse, me mbarimin e studimeve, nuk do të gjejnë punë sipas diplomës që kanë marrë. Kjo do të çojë edhe në rritjen e dëshirës së tyre për të emigruar, si dhe në mungesë motivimi të brezave pasardhës të studentëve, duke parë se diploma që do të marrin nuk do t'u shërbejë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale përkatëse, po vetëm sa për të pasur një status më të lartë. Kjo do të shtyjë jo pak prej tyre, siç po ndodh aktualisht, që, për të fituar këtë status, të kërkojnë ta blejnë e jo ta fitojnë me mund një diplomë universitare, gjë që te ne, siç po duket, nuk është aq e vështirë.

Nuk ka dyshim se pranimi në mënyrë të sforcuar i një numri të madh studentësh në universitetet shtetërore ndikon negativisht në cilësinë e përgjithshme të kontingjenteve që pranohen dhe të produkteve që dalin prej tyre. Po kështu, në kushtet e sotme të universiteteve, ai ndikon negativisht edhe në plotësimin e standardeve evropiane në veprimtarinë e tyre. Puna mësimore e shtuar kufizon kohën për përditësimin e leksioneve nga ana e pedagogëve dhe bëhet në dëm të punës studimore-shkencore, që duhet të jetë komponent i domosdoshëm në veprimtarinë e pedagogëve dhe në të cilën duhet të angazhohen, në një farë mase, edhe studentët. Rekrutimi i menjëhershëm i qindra specialistëve të rinj si pedagogë për dhënie leksionesh, çon, përgjithësisht, në ulje të cilësisë së leksioneve. Nga rritja e shpejtë e numrit të studentëve krijohen shtrëngesa për mjedise e bazë mësimore dhe nuk arrihen në masën e duhur kontaktet pedagog-student.

Në lidhje me pikëpamjen sipas së cilës një nivel i lartë arsimimi i popullsisë është i dobishëm, pavarësisht nga nevojat, edhe sikur kjo tezë të qëndrojë, mendoj se, të

Prof. dr. Pajtim BEJTJA

paktën tani për tani, ajo duhet të zbatohet në mënyrë përzgjedhëse, duke pasur parasysh fushat përparësore të zhvillimit të vendit ose ato që kanë nevoja më të mëdha. Ajo, gjithashtu, duhet të zbatohet me ritme në përputhje me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit dhe pa “i rënë në qafë” cilësisë. Sigurimi i cilësisë është pjesë thelbësore e një sistemi arsimor efektiv, që nuk duhet shpërfillur. Prandaj është e nevojshme të krijohen dhe të forcohen mekanizmat për garantimin e saj, bazuar në dokumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe në praktikatat e mira të vendeve të tjera.

Duhet mbajtur parasysh, gjithashtu, edhe roli i të nxënitorit gjatë gjithë jetës në rritjen e nivelit arsimor të popullsisë. Në lidhje me këtë, edhe vendi ynë e ka të domosdoshme të krijojë “hapësirën shqiptare të të nxënitorit gjatë gjithë jetës”, si pjesë të hapësirës evropiane të të nxënitorit gjatë gjithë jetës. Pjesë përbërëse kryesore e kësaj hapësire janë arsimi dhe formimi profesional i të gjitha niveleve, prandaj reformimi i këtyre sistemeve duhet parë dhe duhet bërë edhe me synimin për të kontribuar në krijimin e hapësirës në fjalë. Kjo është një detyrë komplekse dhe e vështirë, që kërkon kohë dhe investime për t'u realizuar plotësisht, por që e bën të detyrueshme natyra e zhvillimeve në shoqërinë e sotme. Ajo bën thirrje për t'i përdorur në mënyrë racionale investimet, të cilat janë ende larg së qeni të mjaftueshme.

Politika që ndjek shteti në lidhje me arsimin universitar mendoj se duhet të jetë e pandarë nga politikatat arsimore që ndjek ai në përgjithësi, duke marrë parasysh edhe nevojat konkrete e perspektive të shoqërisë. Synimi që të gjithë të mbarojnë arsim të lartë universitar, ngjan me synimin për të krijuar një ushtri të përbërë vetëm nga gjeneralë, pa oficerë të rangjeve më të ulëta dhe pa ushtarë (?), gjë që të kujton atë sentencën: “Unë zot, ti zot, po dhentë kush i kullot?”. Se një inxhinier, p.sh., që në universitet ka marrë arsim me karakter të theksuar teorik, përgjithësisht nuk mund ta kryejë punën e punëtorit të fushës përkatëse, që në shkollë ka marrë arsim me karakter të theksuar praktik. Po edhe sikur të mund ta kryejë, për nga arsimi që ka marrë, a do të ishte e drejtë dhe e leverdishme që punët e një punëtori, të cilat, e shumta kërkojnë një arsim të mesëm profesional trevjeçar, të kryhen nga një specialist me universitet? Ose, a është e arsyeshme që në sportelet e bankave të punojnë në masë ekonomistë të lartë, kur në to kryhen punë rutinë, për të cilat është më se i mjaftueshëm arsimi i mesëm ekonomik? Besoj se një vend i vogël e me ekonomi ende të dobët, si Shqipëria, është herët të sillet si një vend i zhvilluar ekonomikisht e me potenciale të bollshme shkencore, që është në gjendje të plotësojë nevojat e tij për specialistë me arsim universitar dhe, njëkohësisht, të përmbushë në masë edhe dëshirat e të rinjve për të ndjekur këtë nivel arsimi, duke ruajtur standardet e cilësisë. Është vështirë, gjithashtu, të pranohet si e drejtë prirja që në një vend të vogël si Shqipëria, e cila ka kaluar e po kalon gjithfarë vështirësish zhvillimi, çdo qytet kryesor të ketë univer-

sitetin e tij. Kjo, qoftë nga pikëpamja e nevojave, qoftë për faktin se hapja e një universiteti nuk është njëllor si hapja e një dyqani dhe nuk është aq e lehtë që të krijohen kushtet për të përmbushur standardet evropiane të të qenit universitet.

Arsimi universitar duhet të garantojë jo vetëm riprodhimin e thjeshtë të specialistëve të lartë, por edhe krijimin e elitës për çdo fushë veprimtarie që ushtrohet në vend. Po elita është vështirë të krijohet nga universitete që nuk plotësojnë standardet përkatëse e që rrisin jashtë mase numrin e pranimeve. Megjithatë, duhet thënë se ekziston edhe mendimi që sasia çon në cilësi, duke bërë të mundur krijimin e elitës, gjë që mua më duket e dyshimtë, pasi në kushtet tona është vështirë t'u shërbehet si duhet studentëve cilësorë. I dyshimtë do të ishte formimi i elitës edhe në universitetet private, në qoftë se ato nuk e konsiderojnë veten si shërbim publik, po sillen thjesht si biznes. Prandaj mendoj se duhet përshëndetur vendimi që të gjitha universitetet tona, publike dhe jopublike, t'i nënshtrohen një kontrolli të imët nga ekspertë të huaj të akreditimit, dhe, në rast problemesh, t'u nënshtrohen masave që mund të shkojnë deri në mbylljen e institucionit të arsimit të lartë ose në heqjen e licencës për universitetet private. Shpresoj se kjo masë do të shërbejë që universitetet tona të rrisin cilësinë e punës së tyre dhe të nxjerrin specialistë sa më të përgatitur dhe të pëlqyeshëm nga tregu shqiptar i punës dhe jo vetëm nga ai.

Duke u nisur nga nevojat e shoqërisë sonë, mendoj se shteti duhet t'u kushtojë vëmendje më të madhe se deri tani shkollave të mesme profesionale e teknike, duke ndryshuar, në radhë të parë, raportin e tyre me shkollat e mesme të përgjithshme (nga 20:80% në, të paktën, 40:60%). Ato duhet t'u përgjigjen me numër nxënësish dhe me lloje kualifikimesh nevojave të fushave të veprimtarisë profesionale që zhvillohen në vend, në përputhje me prirjet rajonale të zhvillimit ekonomik dhe të tregut të punës. Nga ana tjetër, duhet të bëhen përpjekje për rritjen e statusit të këtyre shkollave, që aktualisht është më i ulët se i shkollave të mesme të përgjithshme, duke i bërë ato tërheqëse (joshëse) nëpërmjet modernizimit të modelit kurikular, për t'ia përshtatur atë kërkesave të tregut të punës dhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit të tij, si dhe masave të tjera. Miratimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KSHK), si dhe masat që po merren aktualisht për arsimin profesional, si përgatitja për miratim e Ligjit të ri për arsimin profesional, strukturimi i arsimit profesional në përputhje me nivelet përkatëse të kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, hartimi i kurikulave të reja për këto kualifikime në dy nivele (qendror dhe shkollor), janë inkurajuese në këtë drejtim. Por, duhet konsideruar domosdoshmëri edhe pajisja e nxënësve të shkollave profesionale e teknike me tekstet përkatëse, problem që ka mbetur pa zgjidhje prej vitesh. Njëkohësisht është e nevojshme të motivohen të rinjtë për t'i ndjekur këto shkolla, në përputhje edhe me aftësitë e prirjet e tyre. Duhet përpunuar mendimi se suksesi profesional nuk varet thjesht nga niveli i shkollimit, po kryesisht nga përputhja e profesionit të zgjedhur, pra dhe e nivelit dhe e llojit të shkollimit, me aftësitë dhe prirjet e individit. Për këtë duhet të japë ndihmën e vet shërbimi i orientimit dhe i këshillimit shkollor e profesional (për karrierë), i cili në Shqipëri është në fillimet e tij dhe prandaj duhet zhvilluar më tej. Pa ndryshimin

e mendësisë që mbizotëron sot në vendin tonë, për të marrë të gjithë arsim universitar dhe pa krijuar kushtet e përshtatshme, është vështirë të shpresosh në zhvillimin e duhur sasior e cilësor të arsimit të mesëm profesional e teknik.

Krijimi i një cikli post-sekondar me orientim profesional për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm, që ka filluar të zbatohet për disa drejtime, do të krijonte mundësi arsimimi dhe punësimi të shpejtë për një numër të konsiderueshëm të tyre, do të pakësonte fluksin e maturantëve drejt universiteteve dhe do të rriste cilësinë e kontingjenteve që hyjnë te këto të fundit.

Arsimi universitar, si dhe nivelet e tjera të arsimit, janë investim dhe shërbim, njëkohësisht. Investimi nuk nënkupton ndarje parash thjesht sipas numrit të studentëve e të pedagogëve apo të ndonjë treguesi tjetër, por menaxhim financiar, në mënyrë që paraja të përdoret në mënyrë sa më efektive, eficiente dhe të dobishme. Aq më tepër që në këtë stad zhvillimi, me gjithë përpjekjet që bëhen, mundësitë e shtetit tonë për financim janë relativisht të pakta. Arsimi universitar, duke mos qenë i detyruar dhe duke qenë shërbim, mendoj se duhet të mbahet jo vetëm me fonde publike, po edhe me kontribute nga përfituesit e tij. Raporti midis financimeve publike dhe kontributeve individuale mund të jetë i ndryshëm dhe i diferencuar sipas kriterëve të caktuara, që sigurojnë një politikë racionale investimesh. Në këtë drejtim praktika botërore njih modelle të shumta dhe shfrytëzon edhe burime të tjera të larmishme financimi për universitetet. Shqipëria mund të përpunojë një skemë të sajën për financimin e universiteteve, që, përveç të tjerave, të nxisë konkurrencën midis ofruesve të shërbimit arsimor dhe të motivojë studentët për rezultate të larta, duke marrë parasysh dhe përvojat e mira të vendeve të tjera.

Problemet e arsimit (dhe ato të formimit), në përgjithësi dhe ato të arsimit universitar në veçanti, janë të shumta, komplekse e të vështira dhe nuk është e lehtë të zgjidhen në mënyrën e duhur brenda një kohe të shkurtër. Për më tepër, arsimi nuk mund t'ua arrijë i vetëm qëllimeve të veta, por krahas me të gjitha politikat që synojnë ndërtimin e një shoqërie të re të balancuar, të bazuar në dije dhe në një ekonomi globale, duke pasur si pikënisje strategjinë e popullsisë. Prandaj ai duhet të harmonizohet dhe të jetë pjesë e pandarë e masave dhe e programeve tërësore ekonomike, të tregut të punës dhe sociale, që marrin parasysh strukturën e lëvizjet e popullsisë dhe burimet natyrore të vendit dhe, mbi këtë bazë, nxisin rritjen ekonomike dhe të punësimi, sipas strategjive sektoriale përkatëse.



# Më shumë kohë dhe kujdes edukimit të fëmijëve në familje

Jo thjesht për të shuar kureshtjen, por si një obligim për fëmijët, për të ardhmen e afërt dhe të largët të tyre, do të ngulmonim se, trinomi shkollë - familje - komunitet mbetet gjithnjë faktor kryesor dhe që kërkon vlerësim të vazhdueshëm për edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve. Në realitetin e sotëm, kur shkolla po integrohet gjithnjë e më tepër me standardet bashkëkohore evropiane, kur tekstet e programet po pasurohen dhe alternohen me përzgjedhje dhe cilësia e tyre vjen e rritet, pjesëmarrja e prindërve dhe ndihmesa e tyre në të mësuar po merr rëndësi të veçantë dhe po shfaq tipare e rrugë të reja në menaxhimin sa më racional të kohës, për t'u dhënë ndihmë sa më të kualifikuar dhe efektive fëmijëve tanë. Që të realizohet plotësisht dhe pa mëdyshje ky objektiv madhor, doemos që duhen investuar energji pune konkrete edhe nga prindërit, familja që është baza e shoqërisë dhe që përgatit fëmijën për t'u futur në rrugën e shkollimit, që ta përgatit atë si një lastar të freskët, të drejtë dhe pa cene e dëmtime fizike e biologjike e psikologjike. Kjo është një garanci e madhe që fëmija të integrohet sa më mirë dhe sa më natyrshëm në mjedisin shkollor dhe të ecë përpara drejt rritjes dhe zhvillimit të tij të vazhdueshëm si qytetar i shoqërisë moderne.

Që të edukosh dhe të moralizosh, duhet të jesh vetë një shembull jete, pune, edukimi dhe model për të vegjlit. Dhe, si i tillë, je në gjendje të ndihmosh fëmijën më shumë sesa me fjalën tënde, me veprën tënde, me të qenit qytetar dhe njeri, me karakter të fortë dhe të palëkundur për të përkrahur të renë dhe përparimtarën, kërkesat e kohës dhe të zhvillimit. Kjo nuk do të thotë që të gjithë prindërit duhet doemos të jenë në kulmin e shkollimit, që të jenë në krye të shkencave dhe zhvillimeve, sepse këto janë raste që nuk i gjen lehtë, por që të jesh njeri dhe qytetar i denjë në radhë të parë, që të transmetosh në jetë dhe në punë vlera njerëzore, kjo varet nga gjithkush, nuk ka të bëjë as me përgatitjen shkencore dhe sociale, por me qëndrimin njerëzor ndaj jetës, punës, njeriut. Kjo ka shumë rëndësi në edukimin e njeriut dhe veçanërisht në edukimin e fëmijëve me vlera morale dhe njerëzore, por edhe me vlera që hapin horizonte dhe të zgjojnë dëshira, nxitje dhe kërkesa për të ecur në jetë dhe për të dhënë secili kontributin e tij në këtë shoqëri moderne, ku ne jetojmë sot.

Mbi të gjitha ne mendojmë se është e domosdoshme që anëtarët e familjes kërkohet të

Nga Fran GJOKA

jenë model në shfrytëzimin sa më racional të kohës për t'u marrë me edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve. Kjo do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgatitjen psikologjike dhe formimin me aftësitë dhe shprehjet më të nevojshme dhe më elementare për t'u integruar sa më lehtë dhe sa më natyrshëm në shoqërinë e sotme demokratike. Në këtë kuadër, fëmijët duhet t'i edukojmë të zbatojnë me rigorozitet një regjim ditor, që, është në përputhje me orientimet dhe këshillat e specialistëve, psikologëve dhe sociologëve, edukatorëve që kanë përvojën e punës frytdhënëse e që garanton të ardhmen e sigurt të fëmijëve.

Dihet se fëmijët nuk janë të njëjtë për të gjithë, sepse secili ka përgatitje e aftësi të ndryshme për të kapur me shpejt ose më ngadalë fjala vjen nivelin përvetësues të dijeve që merren në shkolla. Nëse nxënësve me prirje të veçanta dhe të talentuar, u mbetet më shumë kohë e lirë që të mund ta shfrytëzojnë për zgjerimin e horizontit, për të mësuar gjuhët e huaja për zbatimje, pushim etj., nuk ndodh kjo me ata që janë disi më të ngadaltë dhe që u mungon pasioni dhe dëshira, apo që edukimi i tyre i lihet spontanitetit, në radhë të parë nga ata prindër që, ose nuk i kanë kushtet e duhura ekonomike dhe sociale dhe arsimore, apo ata që neglizhojnë me edukimin e fëmijëve, duke u kënaqur vetëm me faktin se i kanë dërguar fëmijët e tyre në shkollat më të mira, se u japin para çdo ditë për të plotësuar kërkesat e tyre etj. Një prind i tillë harron se, më shumë sesa biznesi i madh që drejton, më shumë sesa ato para që ai depoziton dhe shton përditë në bankë, investimi i tij më i madh është dhe mbetet në radhë të parë edukimi, mirërritja dhe shkollimi i fëmijës së tij, që ai të ndjekë rrugën e drejtë



të dijës për t'u bërë dikush në jetë dhe jo të mburret apo të jetojë me thërrimet apo emrin e babait të tij. Sigurisht që është e domosdoshme të hiqet dorë nga privimi i fëmijëve nga aktivitetet çlodhëse, që fatkeqësisht praktikohet nga disa prindër. Pushimet e çlodhjes duhet t'u kushtojnë po aq rëndësi sa edhe mësimi sepse ato shërbejnë për freskimin e sistemit mësimor, gjë që ndikon për mirë në përvetësimin e dijeve.

Psikologët e sotëm rekomandojnë që fëmijët t'i mësojnë e realizojnë herë pas here administrimin e kohës, ato kërkojnë që brenda ditës nxënësit të dijë se çdo të bëjë dhe çka bërë. Por fëmijët nuk e kanë të lehtë që të bëjnë këtë punë në rrugë krejtësisht të pavarur, ata kanë nevojë për ndihmën e prindit, që të ndërjegjësohen sesa kohë kanë harxhuar për gjëra të parëndësishme në dëm të problemeve mësimore. Psikologu Alan në librin e tij që titullohet "Si të arrini të kontrolloni kohën dhe jetën tuaj", këtij problem i vë shumë rëndësi. Me pak fjalë ai thotë se njerëzit më të suksesshëm e dinë mirë se çdo të bëjnë ditë për ditë. Kur veprohet kështu, nxënësit do të mësohen ta shfrytëzojnë kohën me projekte produktive. Kjo ka rëndësi shumë të madhe jo vetëm për kohën e shkollës por edhe si përgatitje për jetën. Ka raste që fëmijëve ua marrin kohën edhe prindërit. Jo rrallë ndodh që ata t'i ngarkojnë kohë pa kohë me punë të dorës së dytë, ose në dimër kur nuk i krijojnë kushte për studim dhe ata detyrohet "të përgatiten" për të nesërmen duke qëndruar pranë televizorit apo kompjuterit në mes bisedave të anëtarëve të tjerë të familjes. Vetëm ata që merren me studimin e këtij problem, mund ta dinë se si nxënësve u humbet koha që kanë në dispozicion për t'u përgatitur për mësim. Nxënësit nuk janë gjithnjë fajtor për të mësuarit me hope. Në këto kushte s'ka se si ndodh ndryshe. Në radhë të parë janë mësuesit pastaj vijnë prindërit që nuk përpriqen ta harmonizojnë punën, që përfundimisht ta shërojnë këtë plagë që po shfaqet dukshëm në sistemin e punës së nxënësve. Duke qëndruar indiferent, të dy palët nuk mund të nxjerrin kurrë rezultate nga puna që po bën mësuesi. Prandaj lufta kundër të mësuarit me hope të nxënësve në shtëpi mbetet problem përfundimtar në rritjen e cilësisë së procesit mësimor. Edhe bota e jashtme akademike, këtij problem i kushtojnë një vëmendje të veçantë. Aftësinë dhe dhuntinë natyrale të nxënësve të sotëm nuk duhet ta lëmë të na firojnë gjatë periudhës shkollë, pasi kjo është edhe një nga objektivat e reformës së sotme arsimore. Ndodh shpesh që të dëgjosh nga goja e mësuesve e prindërve akuza të forta si më zemërim thonë: "Janë të zgjuar, por nuk mësojnë". Kjo akuzë prindërore ndaj mësuesve lëshohet nga ata që bëjnë pak ose aspak punë për t'i ndihmuar që të ndryshojnë qëndrimin e tyre ndaj mësimi. Kjo kategori mësuesish e prindërisht harrojnë se shoqëria e sotme shqiptare i ka thirrur pikërisht ata që t'i edukojnë edhe këta nxënës me shpirtin e disiplinës shkencore në mësim. Psiko-pedagogët kanë provuar se po të orientohen mirë edhe mjaft nga këta fëmijë bëjnë përpjekje për të kapërcyer vështirësitë. Mësuesit në bashkëpunim me prindërit duhet të punojnë për t'i kalitur vullnetin nxënësve, që të mund të përballojnë edhe vetë kryerjen e detyrave mësimore jetësore në rrugë

të pavarur.

Kjo kërkesë vlerësohet si shumë e rëndësishme dhe bën pjesë në kulturën e re të të nxënësve. E parë në këtë këndvështrim me keqardhje vërejmë aty këtu në shkollë, ku mjaftohen edhe me akuza (këta janë nxënës që nuk mësojnë). Dhe s'bëjnë asgjë konkrete për t'i ndihmuar. Është fatkeqësi e madhe kur fëmijët bien në duar të disa prindërve dhe mësuesve të tillë. Prindërit e mësuesit nuk duhet të tërhiqen nga vështirësitë që paraqet puna më këtë kontingjent nxënësish, sepse po të punohet mirë vjen një ditë kur ata shpërthejnë. Mjafton të kujtojmë edhe Ajshtajnin që deri në moshën 9 - vjeçare nuk fliste normalisht. Në shpirtin e çdo mësuesi duhet të ç'rrënjohet mendimi antipedagogjik që dëgjohet "Shyqyr që ikën, shpëtuam prej tyre!". Kjo mënyrë e të gjykuarit ndeshet në disa shkollë të mesme sidomos tek mësuesit që punojnë me klasat e para dhe të dyta. Duhet të pranojmë se mbartësit e këtyre koncepteve nuk mund të quhen me edukatorë të vërtetë. Jeta shkollë dhe ajo prindërore ka provuar se po të veprohet me kritere shkencore dhe me përkushtim, kjo masë nxënësish mund të përmirësohet dhe të integrohet në veprimtaritë mësimore dhe edukative. Kontrolli i shfrytëzimit racional të kohës ka mjaft vlera konkrete, se parandalon shpërdorimin e saj që është shfaqja më e rëndë e keq administrimit të mundësive reale që ka secili për të ecur përpara. Për këtë problem në kohën e tij ka folur dikur edhe Gjergj Fishta". Si ka me u rritë, siç e lyp arsyeja e detyra po qe se prindërit nuk janë të qytetënuar e përparuar. Prandaj për në daçim që shteti shqiptar të përparojë në udhë të qytetënisë së vërtetë, përpara çdo pune tjetër duhet pasë parasysh edukata e familjes shqiptare tue ba që prindët si dhe fëmija e tyne të jenë të qytetnuem". Kaq rëndësi i vë ai këtij problemi. Pra mësimi dhe edukimi mbeten një proces aktiv që zhvillohet pa ndërprerje çdo ditë.



## 45 vjet në udhën e dijes



**Përgatiti: Nikolin GËRMENJI**

e përgjithshme duke krijuar identitetin e vet dhe duke u vlerësuar si një nga shkollat më cilësore të vendit.

Mijëvjeçari i ri do ta gjejë shkollën në pararojë të arsimit shqiptar duke u bërë një nga shkollat e para ku do të zbatohet profilizimi. Sot, ajo është ndër gjimnazet më të mirë, jo vetëm të rajonit të Korçës, por edhe të gjithë vendit. Nga bankat e saj kanë dalë mbi 6000 maturantë, mbi 4000 prej tyre kanë ndjekur studimet e larta në universitetet si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Gjatë këtyre viteve, 194 nxënës kanë mbaruar studimet me notën

45 Vjet në udhës e dijes, ishte titulli i veprimtarisë së zhvilluar nga gjimnazi “Themistokli Gërmenji” Korçë, me rastin e 45 vjetorit të çeljes së kësaj shkolle.

Veprimtaria e organizuar nga drejtorja e shkollës, mësuesit dhe nxënësit e saj u mbështet nga Bordi i Shkollës, synonte të vinte në dukje rrugën e gjatë dhe të suksesshme të këtij gjimnazi në vite. Në këtë veprimtari të zhvilluar në mjediset e shkollës morën pjesë ish-nxënës dhe mësues të kësaj shkolle, drejtori i drejtorisë rajonale të arsimit z. Arben Belba, rektori i Universitetit “Fan Noli”, z. Gjergji Mero, drejtues të pushtetit lokal, prindër dhe nxënës të shkollës në vite.

“Kanë kaluar 45 vjet nga tingëllima e ziles së parë që shënoi fillimin e një jete të re në Korçën arsimdashëse, djepin e kulturës shqiptare. Në këtë gati gjysmëshekulli ne kthejmë kokën prapa dhe kujtojmë me respekt rrugën e ndjekur dhe të gjithë ata që vunë gurin e parë në këtë ndërtesë të dijes”- kështu do të shprehej në hyrje të fjalës së tij përshëndetëse drejtori i shkollës z. Vangjel Simaku.

Veprimtaria u pasua nga dokumentari i përgatitur nga nxënësit e klasës XIB, në kuadrin e projektit kurrikular “Lajmshkruesi gjimnazist”. Në të viheshin në dukje arritjet dhe sukseset e shkollës në vite dhe mundësitë që hap para saj kurrikula e re e gjimnazit.

### PAK HISTORI

Shkolla e mesme “Themistokli Gërmenji” hapi dyert e saj në vitin 1965. Fillimisht ka qenë e bashkuar me shkollën artistike si shkollë 11-vjeçare. Në vitin 1969 nga bankat e saj doli matura e parë me 58 nxënës. Nga ky vit shkolla funksionoi si shkollë e mesme

mesatare të katër viteve 10, 31 nxënës kanë fituar medaljen e artë, ndërsa pjesëmarrjet në olimpiada, konkurse, veprimtari sportive janë të përvitshme dhe me fitues të shumtë. Këto arritje bëjnë krenarë, jo vetëm nxënësit dhe ish-nxënësit, drejtuesit dhe mësuesit, por të gjithë ata që shohin tek arsimi dhe shkolla tempullin në të cilin projektohet e ardhmja e kombit.

Për të përshëndetur të ftuarit dhe pjesëmarrësit e veprimtarisë nga nxënësit dhe mësuesit e shkollës një koncert me këngë, recitime dhe kërcime, duke i dhënë veprimtarisë ngjyrat festive dhe gjallërinë. Duke shfaqur talentet dhe duke shpalosur aftësitë dhe shprehitë që ata i kanë fituar dhe kultivuar në bankat e shkollës.

Në veprimtari të tilla nuk mund të mos shprehësh respektin, falënderimin dhe respektin për figurat e shquara të arsimit korçar. Nuk mund të mos përmenden emrat e drejtuesve dhe mësuesve të merituar si z. Ilia Treska, drejtori i parë i shkollës, z. Gaqo Tasho, Mësues i Merituar dhe drejtuesi më jetëgjatë i shkollës, dhe shumë figura të njohura të arsimit, intelektualë dhe figura të njohura të qytetit dhe më gjerë që kanë marrë dijet dhe janë formuar në bankat e kësaj shkolle.

### SHKOLLA SOT

Gjimnazi “Themistokli Gërmenji”, i vendosur në qendër të qytetit, ka një infrastrukturë dhe mjedise bashkëkohore. Në të mësojnë 563 nxënës të ndarë në 16 klasa. Kurrikula e re e gjimnazit i ka dhënë shkollës më tepër gjallëri përmes lëndëve me zgjedhje të detyrua dhe të lirë. Shkolla ka një bibliotekë të pa-

sur me mbi 3000 tituj dhe përmes fondeve të përcaktuara për bibliotekat e shkollave fondi i librave do të pasurohet për t'u krijuar mundësinë nxënësve të gjejnë aty literaturën e nevojshme jo vetëm letrare, por edhe shkencore. Laboratorët e informatikës dhe lidhja me internetin, përdorimi i metodave të reja audiovizuale të mësimdhënies i japin shkollës profilin bashkëkohor.

Teoria dhe zbatimi praktik i dijeve realizohet përmes laboratorëve të fizikës, kimisë, gjuhëve të huaja si dhe mjediseve sportive. Kjo hapësirë u mundëson nxënësve që të zhvillojnë talentet, aftësitë dhe njohuritë e marra. Në shkollë punon një staf i kualifikuar i cili është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe ngritjes profesionale të tij.

Rezultatet në rritje të pasqyruara në Maturën Shtetërore do të vlerësohen nga Ministri i Arsimit z. Myqerem Tafaj, i cili gjatë vizitës së tij në këtë shkollë do të pohonte: "Zgjedha gjimnazin "Themistokli Gërmenji", se është një nga gjimnazet më të mira të vendit. Në provimin e letërsisë është gjimnazi që është klasifikuar në vendin e tretë."

Këto arritje si dhe zbatimi me sukses i kurikulës së re të gjimnazit janë themeli i suksesit të një shkolle të konsoliduar. Për këtë, në mbyllje të fjalës së tij, drejtori i shkollës do të shprehej: "Përvjetorët e shkollave janë ndër festat më të bukura që përjeton çdo vend me vizion të qartë për të ardhmen, sepse në fund të fundit **e ardhmja e çdo kombi nis dhe mbaron tek arsimit**. Ja pse sot, ne vijmë sot krenarë për të djeshmen dhe të bindur se arritje më të larta na presin në të ardhmen."

**GËZUAR 45-VJETORIN e shkollës "Themistokli Gërmenji", shkollë emblemë e Korçës.**



# Mësuesia dhe psikologjia

Refat XHINA

Njohja e temperamentit të nxënësve nga mësuesi dhe edukimi i tij.

Temperamenti është tabloja e parë e sjelljes dhe e veprimtarisë së individit. Ajo mund të ndryshojë gjatë përvojës jetësore. Thënë me fjalë të tjera, në jetë mund të ndodh që njeriu flegmatik në kushte të caktuara mund të sillet si kolerik. Edhe ky i fundit mund të paraqitet si melankolik. Këto dukuri mësuesi i vëren gjatë viteve të punës, por nuk është i aftë t'i emërtojë me emrin e duhur. Shpesh mësuesit nuk marrin parasysh natyrën shoqërore të nxënësit, aq komplekse që paraqitet në kohën tonë të ndryshimit. Forca ngacmuese në sistemin nervor, ngjarje të mëdha, të rëndësishme e bëjnë nxënësin të shpërthejë me reagime të forta. Temperamenti i njeriut ka anët pozitive dhe negative të tij, që në rrethana të caktuara ato transformohen. Mësuesi e ka për detyrë të zbulojë te nxënësi cilësitë pozitive, t'i nxisë dhe t'i ushqej ato. Ai e ka për detyrë të informojë edhe prindin për cilësitë e mira të personalitetit të fëmijës me qëllim që edhe ai ta marrë për pikënisje në arritjen e mëtejshme të cilësive pozitive. Kursesi mësuesi nuk duhet të shikojë vetëm bardhë e zi. Mësuesi duhet të ketë një spektër më të gjerë ngjyrash. Dobësitë dhe mosarritjet e nxënësve nuk duhet të identifikohen me cilësitë negative të temperamentit të individit. Në klasë ka nxënës që nuk kanë durim të qëndrojnë 45 minuta pa lëvizur. Ka nxënës që e kanë tepër të vështirë të rrinë pa folur me shokun apo shoqen e bankës.

Ka edhe të atillë që edhe mund të lëviz nga njëra bankë te tjetra. Të tëra këto nuk na thonë aspak se ky apo ai është i fiksuar si tip koleriku dhe patjetër duhet mbajtur nën tutelë të vazhdueshme. Kjo i hap rrugë braktisjes së mësimit, dëshirës për shkollë e për rrjedhojë e çon nxënësin drejt divorcit me shkollën. Mësuesi duhet të dijë mirë që temperamentit të fëmijës e jep dukjen që në moshën parashkol-

lore. Në moshën shkollë, për shkak të rrethanave të veçanta të caktuara, disa cilësi të temperamentit dobësohen edhe zhduken, por lindin e forcohen të tjera, të reja. Kjo bën që të ndryshojë temperamentit i tij. Zakonisht në shkollat tona ende ruhet një farë autoritarizmi akademik, madje fallc nga mësuesit që ndrydhin e iniciativën dhe veprimtarinë e nxënësve. Pa e kuptuar, kultivojmë dhe zhvillojmë cilësi negative të temperamentit të nxënësit. Vetë reagimi dhe sjellja e mësuesve ushtron ndikim të dënueshëm ndaj nxënësve. Temperamentin sanguin e kolerik e imponon të rebelojë apo ta frenojë në atë masë sa të humb besimin në vetvete. Kësisoj, trajnimet e mësuesve duhet të orientohen kah psikologjia shkollë. Kjo jo vetëm për arsyet e lartpërmendura, por edhe për faktin se lënda e psikologjisë, pedagogjia apo edhe metodika e didaktika në shkollat e larta për mësuesi janë trajtuar jo seriozisht nga studentët e mësuesisë. Ndërsa mësuesit me stazh të gjatë pune, pothuajse i kanë harruar ç'kanë mësuar vite më parë. Me keqardhje duhet të pranojmë që mësuesit aktualë nuk studiojnë literaturë pedagogjike e psikologjike, me përjashtim të atyre që imponohen për të fituar kategorizimin e pagës. Po me keqardhje duhet të pranojmë që mësuesit lexojnë më shumë shtypin e ditës për të ndjekur ecurinë e kaheve partiake se sa e Revistën mësuesi...



# Përvojë nga mësues nga Anglia

## Një orë mësimdhënie ndryshe

Mësuesi numri 11 (2557) - dhjetor 2010

Zyra Arsimore Sarandë, për ngritjen e mëtejshme të nivelit cilësor të shërbimit arsimor ndaj nxënësve dhe komunitetit, ka krijuar lidhje me kolegje të Anglisë, si një vend i përparuar evropian, me qëllim që të përçojë në mënyrë të drejtpërdrejtë përvojën më bashkëkohore në fushën e arsimit tek mësimdhënësit tanë, por njëkohësisht të tregojë edhe arritjet shkollës sonë.

Po kthehet në një traditë tashmë ky shkëmbim i përvojës, i nisur që para dy vjetësh dhe po thellohet më shumë duke u shtrirë në disa drejtime që i shërbejnë më së miri edhe objektivit të punës së ZA Sarandë me iniciativën e znj. Lina Vaso, drejtore e këtij institucioni.

Është fjala për zhvillimin e seminarit kualifikues me mësues të matematikës së rrethit, nën drejtimin e mësuesve anglezë. Ishin të pranishëm edhe specialistë të Zyrës Arsimore Sarandë, për të mbështetur grupin e mësuesve angleze, që do të sillnin tek mësuesit dhe drejtues të shkollave të rrethit tonë përvojën e tyre mjaft pozitive.

Kjo veprimtari në fushën metodike të mësimdhënies ishte demonstrimi i një mësimi model të quajtur "master" nga mësues të 2 kolegjeve angleze "Tomas Dikson" dhe "Gledys Boys" në lëndën e matematikës me temë "Matjet dhe shkallët e tyre" për klasën IV. Koha e përcaktuar për zhvillimin e tij ishte 90', pra 2 orë mësimore. Mjedisi i përzgjedhur për të zhvilluar veprimtarinë ishte biblioteka e shkollës 9 - vjeçare "Adem Sheme" Sarandë.

Një ditë e shtune, jo e zakonshme për mësuesit e rrethit të Sarandës, si dhe për drejtorin e shkollës pritëse, Sami Alimema, një ditë që e mbushi me gjallëri shkollën. Oborri ndriçonte në ditën me diell dhe sikur i uronte mirëseardhjen miqve anglezë të shoqëruar nga përkatësit Aferdita Bituni, (koordinatore e këtij bashkëpunimi), të cilët hynë nëpërmjet tij në ambientet e shkollës dhe na përshëndesnin me urimin e bukur në gjuhën shqipe "Mirëmëngjesi!"

Maria NANO Specialiste - ZA Sarandë

Të thjeshtë, të komunikueshëm, seriozë në misionin e tyre me të cilin ata kishin ardhur, por edhe të emocionuar gjatë paraqitjes së mësimin e, natyrshme kjo për këdo, edhe për mësuesin më me përvojë. Ajo që me të vërtetë të prekte, ishte përpjekja e këtyre mësuesve për të thënë fjalë përshëndetëse e prezantuese në gjuhën shqipe, një veprim i bukur e mjaft njerëzor që shprehte veç dëshirë për të krijuar lidhje më të ngrohta e komunikim më të afërt shpirtëror. Duhet të themi se përgatitja e mësuesve anglezë kishte objektiva mjaft të qarta, të thjeshta, të kapshme dhe të arritshme për nxënësit: "Të fitojnë aftësitë për të bërë drejt matjet dhe për të përdorur shkallët e zvogëlimit dhe ato të zmadhimit.

Në ndihmë të arritjes së këtyre objektivave, ishin dhe strategjitë e teknikat e punës në grup dhe shfrytëzimi i aftësive të nxënësve në fusha të tjera, si të vizatuarit, njohja e anatomisë së trupit të njeriut, komunikimi i nxënësve më nga afër për të njohur më mirë njëri-tjetrin, për të pranuar me lehtësi çka është e ndryshme dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunuese ndërmjet tyre, duke realizuar një orë të integruar bukur, në formën e lojës zbavitëse, të këndshme për fëmijët e moshës 10 vjeçare, larg orës së ftohtë tradicionale, por njëkohësisht mjaft frytdhënëse, në marrjen dhe përfitimin e njohurive. Suksesi i kësaj ore ishte tek ideimi i saj me mjaft fantazi dhe tek mbështetja në kapacitetet mësimnxënëse dhe veçoritë psikologjike moshore të tyre. Mjetet e përdorura për realizimin e kësaj ore mësimi, u krijuan nga vetë nxënësit ( mësuesit pjesëmarrës në këtë mësim ) gjatë zhvillimit të punës në grupe prej 4 vetë .

Mësueset angleze, Beti, Maria dhe Hilari, demonstruan me mjaft zotësi e metodikë shkencore temën duke pasur në qendër të orës nxënësin dhe aftësimin e tij praktik. Paraqiten objektivat që duhej të arriheshin gjatë zhvillimit të mësimin, bënë demonstrimin e matjeve

konkretisht dhe më pas, ngarkuan çdo grup për të bërë matjet antropometrike të njërit prej pjesëtarëve të tij dhe për t'i paraqitur ato në fletën e punës, si përmasa reale dhe në shkallën e zvogëlimit 1:5.

Në kurorëzim të kësaj pune, ku secili pjesëtar grupi kishte detyrën e vet, do të ndërtohej modeli i trupit në bazë të matjeve dhe shkallës së dhënë nga mësuesit mentorë. Për këtë qëllim, u ndanë mjetet e nevojshme ndihmëse si: fletë pune, metër, kolorë, pineska metalike, gërshërë dhe fletë kartoni me ngjyrë me anë të të cilave do të pritëshin në formë figurash gjeometrike pjesët e trupit: krahu, parakrahu, qafa, etj të cilat, duke u ngjyrosur e duke u bashkuar me pineska do të ndërtonin trupin e nxënësit me gjithë veçoritë tij fizike ( i gjatë, i shkurtër, i dobët, i shëndoshë etj .) me pak fjalë i ndryshëm nga të tjerët. .

Një ide mjaft e gjetur kjo për të krijuar aftësi



shumëplanëshe të nxënësve, por dhe për të arritur qëllimin kryesor të orës së mësimi: për të fituar njohuritë e nevojshme matematike për kthimin nënfisha dhe shumëfisha të njësisë matëse: m, cm, mm, dm, km, etj. Mësuesit tanë, në rolin e nxënësve, punuan në grup me seriozitetin më të madh për të vënë në zbatim përvojën mjaft të vlefshme të mësuesve anglezë dhe për ta përcuar atë tek nxënësit e tyre në mësimdhënien konkrete. Objektivat e orës së mësimi u arritën në kohën e përcaktuar. Ndërmjet mësuesve anglezë dhe shqiptarë u krijua një klimë shumë e mirë bashkëpunimi dhe bashkëbisedimi në të dyja gjuhët. Kjo gjë, bëri të mundur shkëmbim mendimesh e përvojash personale midis tyre si dhe ngriti më lart figurën e mësuesit shqiptar në sytë e miqve anglezë. Pjesëmarrësit dolën nga ky seminar të entuziazmuar dhe njëkohësisht të bindur se përfituan, me të vërtetë shumë, në drejtim të mësimdhënies, por gjithashtu dhe të sigurt se edhe ata kanë një përvojë shumë të mirë në mësimdhënie. Këtë e treguan punimet me shume vlerë, si makete, pune të duarve të shkathëta, krijime, piktura të nxënësve etj, që ua dhuruan miqve anglezë për të realizuar në këtë mënyrë shkëmbimin e përvojave dypalëshe. Mësuesit anglezë u mrekulluan prej këtyre punimeve që tregojnë se punohet mjaft edhe tek ne, për zhvillimin e aftësive krijuese të shumanshme dhe shprehive praktike të nxënësve.

Në përfundim të këtij seminari, znj. Lina Vaso i falënderoi mësuesit anglezë për këtë veprimtari kualifikuese dhe propozoi që ky

shkëmbim përvojash të shtrihet edhe në lëndët e tjera, pasi do të jetë i dobishëm dhe do të japë rezultate për të dyja palët.

Pas këtij mësimi të suksesshëm, stafi i mësuesve anglezë dhe përfaqësues të Zyrës Arsimore dhe drejtues të disa shkollave vazhduan të pinë kafe miqësisht dhe zhvilluan një bisedë të ngrohtë. Pas kësaj, u ndanë me mbresat më të mira dhe me projekte të reja konkrete bashkëpunimi për orë integruese që të përfshijnë tërë gamën e lëndëve që zhvillohen në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar.



# Dy tekste të Oxfordit të sjellë në shqip

*“Të zëvendësojmë tekstet e mykura me tekste moderne” Sali Berisha*

Po e fillojmë këtë shkrim me një pjesë nga fjala e Kryeminsitrit Sali Berisha, në 27 tetor 2010, në prezantimin e projektit për renditjen e universiteteve, organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ku duke folur për cilësinë në universitete, midis tjerash ai tha: “Ju bëj thirrje të zëvendësojmë tekstet e mykura me tekste moderne. Edhe ky është një kusht që universitetet të jenë vendi i dritës, sepse teksti i mykur është myk. Tekstet janë krijim i grupeve dhe i autoriteteve më të mëdha të shkencave në të cilat ne punojmë. Ndaj edhe një herë thirrja ime shumë miqësore është që të përkthejmë tekstet më të mira të botës, t’i përkthejmë dhe të rivendosim mekanizmin e ribotimit të tyre në përputhje vendin ku janë, në mënyrë që t’u japim studentëve konceptet më të drejta. Universitetet janë vatër drite. Dritë bëjnë ato kur konceptet me të cilat operohet janë të qarta, të kthjella, të vërteta”.

Librat “Fuqia e të menduarit kritik” dhe “Si të shkruajmë shqip”, botime të Oxford University Press, vijnë në shqip në një kohë kur shkolla shqiptare, në të gjitha nivelet e saj, ka në rend të ditës cilësinë dhe, në radhë të parë, përsosjen e metodave të mësimdhënies dhe të të nxënies që parakuptojnë, mbi të gjitha, të menduarit kritik.

Shumica e edukatorëve në botë pohojnë se të menduarit kritik është një proces i gjatë dhe i vështirë, i cili ka një qëllim të madh: t’i çojë nxënësit dhe studentët tek një i menduar kritik dhe krijues, që janë dy anë të një procesi të pandashëm, sepse njeriu, që të jetë krijues duhet të mendojë në mënyrë kritike. Të menduarit kritik është një projekt me përmasa botërore dhe vendi ynë është pjesë e këtij projekti të madh. Para 15 vjetësh vetëm një grup i vogël pedagogësh dhe mësuesish shqiptarë për dy-tre vjet radhazi morën bazat e të menduarit kritik nga pedagogë të shquar nga ShBA, Kanadaja, Anglia etj., ndërsa sot të menduarit kritik në Shqipëri është përvetësuar dhe po zbatohet nga qindra mësues e pedagogë, ai është pjesë e planeve mësimorë në programet e studimit të ciklit të parë dhe sidomos e programeve “Master profesional” dhe po sendërtohet ca nga ca në të gjitha tekstet e arsimit parauniversitar e më tej.

Procesi i të menduarit kritik dhe zbatimi i tij

Prof. dr. ALI JASHARI - Universiteti i Korçës

në shkollën shqiptare ka disa veçori: së pari, filozofike, sepse ai përputhet me qëllimin e madh të arsimit që të përgatitë njerëz të aftë për të përballuar sfidat e kohës. Pa këtë bazë teoria dhe praktika për të menduarit kritik nuk do të kishte qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi; së dyti, psikologjike, sepse, duke qenë një përvojë e sprovuar në shumë vende të botës, edhe tek ne po përshtatet në një mjedis me mendësi të tjera dhe po ndikon shkëmbyerazi që edhe edukatorët shqiptarë të jenë largshikues; që ata “të shkriërojnë” mësimin; t’i bëjnë nxënësit e studentët të shpenguar, që të mësojnë “me kokën e tyre”, të mos bëhen robër të teksteve dhe leksioneve, por t’i përthithin njohuritë në mënyrë kritike dhe krijuese; së treti, pedagogjike, ngaqë të menduarit kritik, jo vetëm që nuk e shkrënd dhe nuk e mohon përvojën e shkollës shqiptare, por e mënd atë me ide dhe mjeshtëri të reja, të cilat, të zbatuara siç duhet, nuk kanë për t’u dukur si “mish i huaj” për shkollën shqiptare; së katërti, pragmatike, sepse në këtë mënyrë shkolla shqiptare do të arrijë sa më shpejt simotrat e saj në botë dhe të ecë në një hap me to.



Libri “Fuqia e të menduarit kritik” është i një lloji të veçantë në kolanën e botimeve për të menduarit kritik, ngaqë bën një trajtim të plotë të metodave për të arritur një shpjegim më të mirë dhe jep një pamje më të gjerë të arsytimit shkencor (arsyetime induktiv dhe shkaksor, metoda shkencore për vlerësimin e njohurive etj.), duke sjellë module për të shkruar me një përshkallëzim të natyrshëm dhe me grupe të llojllojshme ushtrimesh praktike.

Aparati pedagogjikoshkencor i këtij teksti është një gjedhe (model) nga duhet të përfitojnë mësuesit, pedagogët dhe hartuesit e teksteve mësimorë, sidomos për stilin e qartë të të shkruarit, kutizat e shumta me informacion që jepen për shënime përmbyllëse, për çështjet kryesore të kapitujve të mëparshëm dhe leximet jashtë klase. Të gjitha këto shoqërohen me shumë shembuj dhe ilustrime grafike, që e bëjnë tekstin edhe më tërheqës.

Por “Fuqia e të menduarit kritik” nuk do të ishte e tillë, nëse nuk do të përcilleshin në shqip konceptet për të menduarit kritik, nëse nuk do të krijoheshin në shqip një sistem i tërë fjalësh-kyçe e termash, që ai “të flasë shqip” me të vërtetë, duke bashkëmbartur së brendshmi mjedisin shqiptar, mendësinë e edukatorëve shqiptarë, traditën tonë arsimore etj.

“Fuqia e të menduarit kritik” ka një lidhje të natyrshme me librin “Si të shkruajmë shqip”, një manual i Oxfordit për të shkruar dhe retorikën, i përshtatur për shqipen.

“Si të shkruajmë shqip”, i sjellë mjeshtërisht në shqip nga prof. Xhevat Lloshi dhe Majlinda Nishku, është një udhërrëfyes për ligjërimin e shkruar, me një doracak praktik për kulturën gjuhësore.

Për teorinë dhe praktikën e procesit të të shkruarit janë botuar libra e udhëzues gjithandej, por kur lexon këtë libër të Thomas S. Kane, krijon bindjen e plotë se arti i të shkruarit është një mrekulli e pafundme dhe një sfidë intelektuale e rendit të lartë, siç thuhet në hyrje të tij.

Në kontekstin e këtyre radhëve, është domethënëse shprehja latine “cui scribit, bis legit” (kush shkruan lexon dy herë). Në hyrjen dhe 31 krrerët e këtij libri, me përmbi 780 faqe, lexuesi i zellshëm dhe i vëmendshëm do të gjejë të gjitha çështjet teorike dhe rregullat praktike për procesin e të shkruarit, si për strukturën e esesë, për llojet e esëve (argumentuese-bindëse, letrare, kërkimore etj.), për paragrafin dhe gjedhet e tij, për fjalinë dhe zgjedhjen e fjalëve, për pikësimin etj., të konkretizuara me pjesë nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore.

“Fuqia e të menduarit kritik” dhe “Si të shkruajmë shqip” janë dy libra të veçantë për bibliotekën shqiptare, si për nga mbushullia e informacionit të përzgjedhur që japin, ashtu dhe ushtrimet praktike që ngërthejnë. Për këto veçori, ata duhet të jenë pjesë e leximit të përditshëm të nxënësve, studentëve, mësuesve, pedagogëve shqiptarë dhe gjithë njerëzve të fushës së letrave.

*“Fuqia e të menduarit kritik” dhe “Si të shkruajmë shqip” janë dy libra të veçantë për bibliotekën shqiptare, si për nga mbushullia e informacionit të përzgjedhur që japin, ashtu dhe ushtrimet praktike që ngërthejnë. Për këto veçori, ata duhet të jenë pjesë e leximit të përditshëm të nxënësve, studentëve, mësuesve, pedagogëve shqiptarë dhe gjithë njerëzve të fushës së letrave.*



## E bardha dhe e kuqja e Etit

ESE

Xhevahir SHTUPA

*Jetullah Haliti, me pseudonimin Eti, u lind më 20 nëntor 1945 në fshatin Haxhaj të Gjilanit në Kosovë. Titullin "Profesor" e ka marrë në vitin 1982. Prej vitit 1985 mban statusin e piktorit të pavarur i cili edhe kalon nëpër Evropë për t'u prezantuar si artist i lirë.*

*Është anëtar i SHAF të Kosovës dhe UNESCO-S në Paris si dhe anëtar aktiv i Akademisë Evropiane të Arteve që nga viti 1997. Është themelues i Profondizmit-stil i ri që përfaqëson Post-Modernen në artet figurative dhe i Institutit të Artit Profondist themeluar më 01.07.2001 në Luksenburg e që mban emrin "ETI" si themelues i tij. Është vlerësuar me 9 medalje ari e 5 argjendi në Belgjikë, në Francë, në Zvicër etj.*

*Për ciklin e tij famoz "Pëllumbat e Paqes" është propozuar kandidat për "çmimin NOBEL për PAQE", i pari kandidat nga artet figurative. Është autori i një projekti pedagogjiko-didaktik të titulluar "Emancipimi i brezit të ri nëpërmjet edukatës së arteve figurative". Aktualisht ligjëron Metodikën e artit figurativ në Universitetin e Prishtinës.*

ETI është "shqiptar, kosovar, Zot e krenar, Zot e bujar",- siç do të thoshte Mitrush Kuteli. Tek ai, atdhetari, artisti e intelektuali shkrihen në një.

**Si atdhetar.** Ai ndien e mendon se Kosovës, Shqipërisë e mbarë kombit, i shërbehet më mirë atje në sallonet e artit të qyteteve e kryeqyteteve evropiane.

Po me se? Me atë që është më universale e më paqësore e që ai e ka më për zemër, me pikturën. Atdhetari Eti merr pak dhe kosove dhe e shpie në një nga Metrololet më të mëdha të Evropës; në Paris. Shohim një nga tablotë e ciklit ; **"Pak dhe Kosove në Paris"**

Një copëz toke e pluguar. Dheri-një përzierje ngjyrash; i zi në të kuqërremtë. Mbi ugar disa pikla që të kujtojnë vesën e mëngjesit, por jo, më shumë na ngjajnë me bulëza djerse. Piktori sikur apelon:

- Merreni dhe analizojeni këtë dhe! Ka humus (ngjyra e zezë). Është dhe pjellor. Prodhon bukë. Mban gjallë Jetën. Ky dhe është i mburitur me djersë, me gjak e me lot.

Kur barbarët në marshin e tyre të egër këndojnë ( kërcënojnë ):

" Nga terri vijmë, në terr shkojmë

...

Unurin e eshkën i marrim me vete

...

Ne korrim jetë...

...

Lëkurën e fëmijëve e qesim në pazar..."

(Vargjet janë marrë nga poezia " Marshi barbar" e Sabri Hamitit:

Ky dhe- kosove, atje në Paris buçet me zë kaba:

" Mjaft më! Jo karbonizim ( shkretim )!

Barbarët që vrasin e presin, që djegin e shkrumbojnë veç shkretim lënë pas.

Fëmijët e mi duan Paqe. Ata rritin pëllumba të bardhë e i lëshojnë në qiellin evropian për të dhënë mesazhe paqeje e për të kërkuar mirëkuptim".

**Si artist.** Arti hap dritare. Duke vështruar nëpër to sheh më mirë Jetën e Botën.

(Cikli " Dritaret e jetës" )

Profesor Haliti, krijimtarinë e tij e ka ideuar dhe realizuar në cikle tematike, gjë e cila e ka ndihmuar mjeshtrinë të strukturojë e të mbartë figurat simbol nga cikli në cikël, nga tabloja në tablo, për të lehtësuar komunikimin e përcjelljen e mesazheve tek shikuesit.

Vetë emërtimi i cikleve është shumë domethënëse:

" Pëllumbat e paqes", "Dritaret e jetës", "Origjina", "Anatomia e vezës", " Homazh Dante Aligerit", " Homazh Kodrës e Pikasos", " Pak dhe Kosove në Paris", " Dialog i zogjve", "Karbonizimet", " Portreti tragjik" etj.

**Si intelektual.** Sukseset si piktor i kanë dhënë kurajën civile që ai të komunikojë e të kërkojë nga institucionet ndërkombëtare e nga të mëdhenjtë e politikës botërore mbështetje për atë që është legjitime për popullin e Kosovës: **Mbrojtjen e të drejtave themelore, Lirinë e Pavarësisë.**

## Ngjyrat

Kritikët vërejnë e Eti pohon se ngjyra e tij më e preferuar është e bardha.

E bardha: Është veza ( nga lind jeta ), qumështi ( tambli)i gjinjve të nënave (që ushqejnë jetën), vellua e nuseve ( martesë; gëzimi, lulëzimi e vazhdimësia e jetës).

Sa i bukur urimi ynë në dasma: " çifti të na trashëgohet!"

I bardhë plisi kosovar. I bardhë shalli i rugovasve që e mbajnë me vete si qefin se " burrit nuk i dihet ku e ka dekën". Të bardha luledet që çelin lëndinave e luadheve të Kosovës. I bardhë shpirti ynë, shpirti i piktorit e sidomos shpirti i fëmijëve tanë që duan e rritin pëllumbat e paqes e i lëshojnë në qiellin e kaltër.

Siç thekson Dr. Remzi Përnaska : " Tek mjeshteri ynë, e bardha është bartëse e së resë, është pjesa rematike e pikturës së tij."

E bardha- është ëndrra e aspirata jonë.

E kuqja: Është historia. Është gjaku i derdhur për liri. Janë lulëkuqet e bozhuret e Kosovës. " Xhamadani i Mic Sokolit".

I kuq është zjarri në vatrat tona. I kuq është flamuri ynë kombëtar. E kuqja ushqen të bardhën. Gjaku ushqen jetën.

Ja si u flet poeti Din Mehmeti dëshmorëve:

" Flini të qetë!

Kjo tokë ju lindi

nga hiri i ëndërrave të lirisë,

që të rriten lulet e bardha

në mendjen e njerëzimit

që nga shpirti të shpërthejë bardhësia,

që liri të ketë me bollëk,..."

(Nga poezia " Që të rriten lulet e bardha")

E kuqja e Etit është vetë Kosova me historinë e saj.

" Made-in Kosova", siç u përgjigjet ai evropianëve.

E kjo është atdhetari, është e folur ( komunikim ) me gjuhën e bukur të pikturës, është edhe akt guximi qytetar.

## Simbolika e emrit - ETI

Po marr guxim të shkoj pak më tej në meditim të komentit tim. Këtë guxim ma jep përmbajtja e veprës së Profesor Halitit, fisnikëria e thjeshtësia e tij.

Unë mendoj e ndiej se midis pikturës e poezisë ka një lidhje e ndikim të gjithhershëm. Sonetin “Zanoret” e poetit simbolist francez Artur Rembo estetët e kanë quajtur “Soneti i ngjyrave”.

“... E-e bardhë, I- e kuqe...”

( Nga soneti “Zanoret” )

Këto dy zanore; E dhe I, pra e bardha dhe e kuqja shoqërojnë e do të shoqërojnë gjithmonë bashkëtingëlloren T që është Tema e krijimtarisë së ETI-t.

T- është toka, atdheu, trualli, shtëpia, vatra atërore, tradita, mikpritja. Është vendlindja ku piktori u lind e u bë burrë. Ai e ka pjesë të emrit e të mbiemrit, pjesë të identitetit, thelbin e vetë qenies së tij e të veprimtarisë krijuese. T është talent, përkushtim ( punë ) e trimëri ( guxim krijues ).

T- ( më në fund ) është sukses, është fitore, është Triumf. E triumfi na kujton Maratonmakun e Nolit, “... Për triumfin lajmëtar”.

Pikërisht, me talentin e tij, e më shumë me përkushtimin e vazhdueshëm e me guxim krijues, Profesori nga Gjilani i Kosovës ( që është dhimbja e krenaria jonë ) u bë Akademik Evropian.... Ky është vërtet një triumf.

T- tema kosovare në krijimtarinë e tij i ka të gjitha ngjyrat brenda, por gjithmonë do të jenë aty e do të përçojnë simbolikën e vet: e kuqja dhe e bardha.

## Një kryevepër arti

“Origjina” (ose “Zanafilla”). Një koncentrat mendimi e bukurie artistike. Një vepër arti sa universale, aq dhe kombëtare. Si një vezë ( ku zë fill jeta ). Si koka e një valltari nga ansambli “Shota” ku shquhet qartë mbi ballë shamia e lidhur pas e mbi krye plisi kosovar. Por piktura ngjan edhe si një kullë e malësive tona. Gurët po vendosen... Shohim lastarë bimësh të harlisura. Jeta po lëvrin.

“Jam si më sheh

e si më njeh:

kësule- bardh e krye- lith,”

(Nga Kënga e dytë, “Poem Kosovar” e Kutelit)

Piktori evokon lashtësinë e shqiptarëve që është aq sa Bota.

“Bota që kur është zënë,

Shqipëria gjall’ ka qënë.”

( Nga poemti “Shqipëria” e Naim Frashërit.

Ç’bëjnë zemrat atdhedashëse dhe mendjet e ndritura! Atë të vërtetë që e theksonte në poezi, në një moment kyç të Rilindjes Kombëtare shqiptare, Naimi e pohonte me zërin kaba, me dhimbje Mitrushit në “Poem kosovar” më 1944, e rithekson në pikturë, mjeshtëri Eti, tani në kohët moderne. Naimi e shkroi atëherë për të marrë vesh Turqia dhe Evropa

Plakë se kishte Shqipëri.

Eti pikturoi “Origjinën” për të marrë vesh Serbia e për ta kuptuar, tani, më mirë çështjen shqiptare, Evropa e Re.

## Mbresa

Më 14 gusht 2009 u hap për herë të parë në Pogradec ekspozita personale me 48 punime të përzgjedhura nga ciklet më të realizuara të autorit.

Në ditën e dytë të ekspozitës pata rastin e lumtur që të jem i pranishëm në një bisedë të ngrohtë e vëllazërore me Profesorin në mjedisin e këndshëm e piktoresk, aty pranë Odeonit të qytetit. Ishin të pranishëm edhe Dh.Gegprifti, gazetar, Islam Bakollari, mësues e piktor e pak më vonë, veterani i gazetës “Mokra” Llazi Tona.

Për gati tri orë dëgjuam e mësuam shumë nga ky artist me përmasa evropiane. Pas bisedës bëmë fotografi pranë monumentit të Lasgushit e pamë ekspozitën.

Të gjithë ata piktorë, mësues, gazetarë e artdashës (pogradecarë) e më tej që patën rastin të takohen e të bisedojnë me Profesor Etin, besoj se janë në një mendje me mua: Ai të bën për vete me modestinë e thjeshtësinë e tij. Për mua si mësues e si mokrar ky takim ishte plotësimi i një ëndrre.

## Vlerësim, falënderim e urim

Si bashkëkombës, si njeri e si artist, me sukseset, modestinë e thjeshtësinë e tij karakteristike piktori J. Haliti-Eti është për t’u admiruar e një model për gjeneratat e reja. Eti është sot

një nga misionarët më aktivë në proceset integruese të kombit tonë në Evropë e në Botë.

“Pëllumbat e Paqes”, me dorën e ETI-t i kemi shpënë, ka herë, atje, në sallën e Parlamentit Evropian.

Veip Proda, autori i monografisë për Akademikun Eti, në parathënien e saj shkruan:

“Jetullah Haliti-Eti, është tashmë një Maratonmak shqiptar,... që vrapon e vrapon..., për të theksuar unin, identitetin dhe personalitetin e atdheut e të kombit shqiptar.”

Profesor ETI:

Duke ju uruar për të gjitha sukseset dëshiroj që si shqiptar t’ju them:

Faleminderit që në konkurse (gara) ndërkombëtare duke fituar na nderoni kombin. Kjo na shton krenarinë.

Si mësues, Ju falënderoj që punoni për të realizuar projektin pedagogjik-didaktik të titulluar:

**“Emancipimi i brezit tëri nëpërmjet edukatës së arteve figurative”.**

**S’ka punë më të bukur se sa të punosh për fëmijët e me fëmijët.**

**Së fundi, si artdashës:**

**Ju falënderoj për vlerat estetike të krijuara e për mesazhet jetësore që aq bukur i përcillni nëpërmjet pikturës.**



**Revista “MESUESI”**  
ju uron  
mësuesve, nxënësve  
dhe komunitetit  
pranë shkollës,

**Gëzuar Festat**

*Si mund të kontaktoni me ne:*



**Nina Gjoçi:**  
ngjoci@mash.gov.al;  
tel. 04 222 5859



**Vjollca Spaho:**  
vspaho@mash.gov.al;  
cel. 069 5376532



**Andon Andoni:**  
aandoni@mash.gov.al;  
cel. 069 4439598

Adresa e redaksisë: Rruga e Durrësit (pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës), nr. 23 - Tiranë  
tel. 04 2227206 - [revistamesuesi@mash.gov.al](mailto:revistamesuesi@mash.gov.al)

U shtyp në shtypshkronjën “ALBDESIGN” - Autostrada Tiranë-Durrës km. 5 - [www.alb-design.net](http://www.alb-design.net)